FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 98

Tiranë – E hënë, 8 korrik 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11209, datë 25.6.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 26.6.2019	Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)	7093
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 481, datë 27.6.2019	Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë.....	7104
Urdhër i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 23, datë 1.7.2019	Për miratimin e rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë procesit *online* të inspektimit" për inspektoratet shtetërore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë.....	7111
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 5.7.2019	Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë.....	7118

DEKRET
Nr. 11209, datë 25.6.2019

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Habibe Adem Ademi (Canolli)
2. Trim Agim Ademi
3. Muharrem Hevzi Sahiti
4. Gabriella Nikoll Kqira
5. Elizabeta Ndok Markprekaj
6. Bergita Man Bardhoku
7. Ardiana Dedë Nrekaj
8. Bete Tomë Mataj
9. Ermal Shkelzen Panduri
10. Tarek Mohamed Shaker Ragab Ahmed Fahmy Ragab Ahmed Ragab
11. Rejhan Enver Vuniqi (Haxhiu)
12. Leonidio Antonio Biancotto
13. Alban (Aljban) Kurtish Kurti
14. Dafina Gasper Kqira
15. Vjosa Musa Dobruna
16. Drini Ekrem Rexha
17. Erolld Jusuf Belegu
18. Dion Erolld Belegu
19. Hany Abdelaziz Abdelsalam Elhabiby (El Habiby)
20. Nihal Mohamed Kamaleldin (Kamal El Din) Mohamed
21. Petrit Avgustin Ukaj
22. Tea Erolld Belegu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 429, datë 26.6.2019

PËR CILËSINË E DISA LËNDËVE TË DJEGSHME, TË LËNGËTA, PËR PËRDORIM TERMIK, CIVIL E INDUSTRIAL, SI DHE PËRDORIM NË MJETET E TRANSPORTIT UJOR (DETAR, LUMOR DHE LIQENOR)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "b", të nenit 14, të ligjit nr. 162, datë 4.12.2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është reduktimi i shkarkimeve të dyoksidit të squfurit, që vjen nga djegia e lëndëve djegëse të lëngëta, të prodhuara nga hidrokarburet, që, duke përmirësuar cilësinë e tyre, të zvogëlojë efektet e dëmshme te njeriu dhe mjedisi.

2. Reduktimi i shkarkimeve të dyoksidit të squfurit, që vjen nga djegia e lëndëve djegëse të lëngëta të prodhuara nga hidrokarburet, arrihet duke përmirësuar cilësinë e tyre, nëpërmjet vendosjes së kufizimeve për përmbajtjen e squfurit në këto lëndë djegëse, si kusht për përdorimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, ujërat territoriale të Shqipërisë, zonat ekskluzive ekonomike dhe zonat e kontrollit të ndotjes.

3. Kufizimet lidhur me përmbajtjen e squfurit për lëndët djegëse të lëngëta të prodhuara nga hidrokarburet nuk zbatohen për lëndët djegëse të lëngëta të përdorura:

a) për kërkime dhe testime;

b) për përpunim para djegies përfundimtare;

*Ky vendim përafron pjesërisht direktivën (EU) 2016/802, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 11 maj 2016, në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë të djegshme të lëngshme"

c) për përpunim në industrinë e rafinerisë;

ç) për anijet luftarake dhe anije të tjera për qëllime ushtarake, kur nuk dëmtohet aftësia operacionale e tyre;

d) në anije me qëllim të shpëtimit të jetës në det dhe të sigurisë së anijeve;

dh) në anijet që janë dëmtuar, me kusht që të gjitha masat e nevojshme për parandalimin ose reduktimin e shkarkimeve janë marrë menjëherë pas dëmtimit. Kjo nuk do të zbatohet nëse pronari ose zotëruesi ka shkaktuar dëmin në mënyrë të qëllimshme ose nga pakujdesia;

e) në bordin e anijeve që përdorin metoda të reduktimit të emetimeve në përputhje me kreun VI, të këtij vendimi.

4. Ky vendim përcakton:

a) llojet e lëndëve djegëse të lëngëta dhe vlerat kufi të përmbajtjes së squfurit në to;

b) treguesit fiziko-kimikë të lëndës djegëse, të cilat duhet të përmbushen përpara tregtimit të tyre;

c) kushtet e përdorimit të lëndëve djegëse të lëngëta nga anijet në portet, ujërat territoriale të Shqipërisë, zonat ekskluzive ekonomike dhe zonat e kontrollit të shkarkimit të oksideve të squfurit në ajër;

ç) mënyrën e përcaktimit dhe të monitorimit të treguesve tekniko-cilësorë të lëndës djegëse;

d) metodat për reduktimin e shkarkimeve të lëndëve, ndotësve në ajër, dhe raportimin e përputhshmërisë me vlerat kufi të përmbajtjes së ndotësve.

5. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

a) "Anije e ankoruar", anijet e lidhura ose të ankoruara në një port të territorit të Republikës së Shqipërisë gjatë ngarkimit, shkarkimit ose qëndrimit, duke përfshirë kohën e shpenzuar kur nuk janë të angazhuara në operacionet e ngarkesave.

b) "Anije luftarake", një anije që i përket forcave të armatosura të një shteti që mban shenjat e jashtme të nacionalitetit të tij, duke u dalluar nga anijet e vendit pritës, nën komandën e një zyrtari të autorizuar nga qeveria e shtetit dhe emri i të cilit shfaqet në listën përkatëse të shërbimeve ose në ekuivalentin e tij dhe që drejtohet nga një ekuipazh që është nën forcat e rregullta të armatosura.

c) "Anije pasagjerësh", anijet që mbajnë më shumë se 12 pasagjerë, ku pasagjer është çdo person në bord, përveç fëmijëve deri në një vjeç, anëtarëve të ekuipazhit dhe personave të punësuar në një anije.

ç) "Gaz i lëngët i naftës", çdo lëndë djegëse e lëngët e gaztë e prodhuar nga hidrokarburet, e destinuar për qëllime përdorimi rezidenciale, industriale, automjete ose për përdorim në bordin e një anijeje, të përcaktuara sipas standardit SSH EN 589 dhe SSH ISO 9162.

d) "Impiant me djegie", çdo pajisje teknike ku lëndët djegëse oksidohen, në mënyrë që të përdoret nxehtësia e prodhuar.

dh)"IMO", Organizata Ndërkombëtare Detare.

e) "Lëndë djegëse e lëngët e rëndë*" (heavy fuel oil):*

i) çdo lëndë djegëse e lëngët e prodhuar nga hidrokarburet, duke përjashtuar lëndët djegëse të lëngëta detare, që përfshihen në kodet CN: 2710 19 51 deri 2710 19 68, 2710 20 31, 2710 20 35 ose 2710 20 39

ose

ii) çdo lëndë djegëse e lëngët e prodhuar nga hidrokarburet, përveç gazoilit siç përcaktohet në shkronjën "b", të kësaj pike, dhe lëndëve djegëse të lëngëta detare të përcaktuara në shkronjat "c", "ç" dhe "d", të kësaj pike, e cila, për shkak të kufijve të saj të distilimit, përfshihet në kategorinë e lëndës djegëse të lëngët të rëndë, të destinuar për përdorim si lëndë djegëse dhe prej së cilës më pak se 65% ndaj volumit (duke përfshirë humbjet) distilohet në 2500C sipas metodës SSH EN ISO 3405 (ASTM D-86). Në qoftë se distilimi nuk mund të përcaktohet sipas metodës SSH EN ISO 3405 (ASTM D-86), produkti hidrokarbur do të kategorizohet si lëndë djegëse e lëngët e rëndë.

ë) "Lëndë djegëse e lëngët e mesme-rëndë" (*gas oil*):

i) çdo lëndë djegëse e lëngët e prodhuar nga hidrokarburet, përjashtuar lëndët djegëse të lëngëta detare, që përfshihen në kodet CN 2710 19 25, 2710 19 29, CN 2710 19 47; CN 2710 19 48; CN 2710 20 17; CN 2710 20 19;

ose

ii) çdo lëndë djegëse e lëngët e prodhuar nga hidrokarburet, përjashtuar lëndët djegëse të lëngëta detare, prej së cilës më pak se 65 % ndaj

volumit (duke përfshirë humbjet) distilohet në 2500C prej së cilës më pak se 85% ndaj volumit (duke përfshirë humbjet) distilohet në 3500C sipas metodës SSH EN ISO 3405, ekuivalente me metodën (ASTM D-86).

Përjashtohen nga ky përkufizim lënda djegëse e lëngët diezel, sipas përcaktimit në vendimin nr.147, datë 21.3.2007, të Këshillit të Ministrave "Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzinë dhe diezel" dhe lëndët djegëse të lëngëta të përdorura për makineritë lëvizëse jorrugore dhe për traktorët e makineritë e tjera bujqësore.

f) "Lëndë djegëse e lëngët detare" (*marine fuel*), çdo lëndë djegëse e lëngët e prodhuar nga hidrokarburet, e destinuar për përdorim ose në përdorim në bordin e një anijeje, përfshirë edhe ato lëndë djegëse të lëngëta të përcaktuara në SSH ISO 8217. Përfshihet, gjithashtu, çdo lëndë djegëse e lëngët e prodhuar nga hidrokarburet, që përdoret në bordin e anijeve për lundrim të brendshëm ose anijeve të përdorura për sport, rekreacion dhe kohën e lirë, kur këto anije lundrojnë në ujërat e detit.

g) "Lëndë djegëse e lëngët diezel detare" (*Marine diesel oil*), çdo lëndë djegëse e lëngët detare, siç është përcaktuar në kategoritë DMB, në tabelën I, të SSH ISO 8217 me përjashtim të referencës ndaj përmbajtjes së squfurit.

gj) "Lëndë djegëse e lëngët e mesme-rëndë detare" *(Marine gas oil*), çdo lëndë djegëse e lëngët detare siç është përcaktuar në kategoritë DMX, DMA dhe DMZ, në tabelën I, të SSH ISO 8217 me përjashtim të referencës ndaj përmbajtjes së squfurit.

h) "MARPOL", nënkupton Konventën Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, të ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.9594, datë 27.7.2006, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare "Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973, të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (Marpol 73/78)"".

i) "Metodat e reduktimit të shkarkimeve", çdo pajisje, material, aparaturë që instalohet në një anije ose çdo procedurë, lëndë djegëse alternative ose metodë përputhshmërie, që përdoret si alternativë për të zvogëluar squfurin në lëndët djegëse të lëngëta detare, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, që janë të verifikueshme, të matshme dhe të detyrueshme.

j) "Metoda ASTM", metodat e përcaktuara nga Shoqata Amerikane për Testimin dhe Materialet sipas botimit të vitit 1976, mbi përkufizimet dhe specifikimet standarde për hidrokarburet dhe produktet lubrifikuese.

k) "Shërbime të rregullta", linja e trafikut të pasagjerëve në mes dy ose më shumë porteve ose një udhëtim i mbyllur me kthim tek i njëjti port, i cili zhvillohet sipas një orari të publikuar të lundrimit ose me frekuencë të rregullt që përfaqëson orarin e vendosur të lundrimit.

l) "Shtojca VI e MARPOL", nënkupton shtojcën e titulluar "Rregullat për parandalimin e ndotjes së ajrit nga anijet", i cili është protokolli i vitit 1997, që iu shtua MARPOL-it.

ll) "Vendosja në treg e lëndëve djegëse të lëngëta", këtej e tutje tregtimi nënkupton importimin, eksportimin, blerjen dhe shitjen e lëndëve djegëse të lëngëta për përdorim termik e industrial, si dhe lëndëve djegëse të lëngëta detare për djegie në bord, duke përjashtuar lëndët djegëse të lëngëta detare, të ngarkuara në anije mallrash për eksport.

m) "Zonat e kontrollit të shkarkimeve të SOx", janë zonat detare të përcaktuara si të tilla nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO), sipas shtojcës VI të MARPOL-it.

6. Bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij janë shtojcat, si më poshtë vijon:

Shtojca 1: Treguesit e lejuar mjedisorë për lëndët djegëse (vajguri-gazoil) për përdorim termik, civil dhe industrial.

Shtojca 2: Treguesit e lejuar mjedisorë për lëndët djegëse (distilate të rënda nga nafta) për përdorim civil teknik dhe industrial.

Shtojca 3: Treguesit mjedisorë për lëndët djegëse detare (*marine fuel*).

Shtojca 4: Treguesit e cilësisë për gazin e lëngëzuar që përdoret për automjete dhe qëllime rezidenciale.

Shtojca 5: Metoda e përcaktimit të vlerës ekuivalente të shkarkimeve në atmosferë.

Shtojca 6: Kriteret për përzgjedhjen e metodave të reduktimit të shkarkimeve të squfurit.

KREU II
PËRMBAJTJA MAKSIMALE E SQUFURIT NË LËNDËT DJEGËSE TË LËNGËTA, TË RËNDA

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm tregtimi i lëndës djegëse të lëngët të rëndë, si lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial, që në nomenklaturën e mallrave përshkruhen në kodet gazi i lëngët CN 2710 19 51 deri CN 2710 19 55; CN 2710 19 62 deri CN 2710 19 68; CN 2710 20 31 deri CN 2710 20 39, që plotëson kërkesat e standardit shqiptar SSH EN 589, SSH ISO 9162dhe SSH UNI 6579 ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me to, me përjashtim të kushtit për përmbajtjen e squfurit, siç parashikohet në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Përmbajtja e squfurit në lëndët djegëse të lëngëta të rënda nuk duhet të kalojë 1,00% ndaj masës.

3. Kërkesa e pikës 2, të këtij kreu, nuk zbatohet deri më 31 dhjetor 2027, për impiantet industriale, subjekt të ligjit nr.10448/2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, në varësi të monitorimeve përkatëse të shkarkimeve në ajër nga autoritetet kompetente për lëndët djegëse të lëngëta, të rënda, që përdoren:

a) në impiantet e mëdha me djegie që janë në përputhje me vlerat limite të shkarkimeve të SO2 në ajër;

b) në impiantet e mëdha me djegie, subjekt i planeve kombëtare të reduktimit të shkarkimeve në ajër, për të cilat mesatarja mujore e shkarkimeve të dyoksidit të squfurit nuk e kalon vlerën 1700 mg/Nm^3, për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara prej 3%, në kushte të thata;

c) në impiantet me djegie, të ndryshme nga ato të përcaktuara në shkronjat "a" ose "b", të kësaj pike, për të cilët mesatarja mujore e shkarkimeve të dyoksidit të squfurit nuk e kalon vlerën 1 700 mg/Nm^3, për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara prej 3%, në kushte të thata;

ç) për djegie në rafineri kur vlera mesatare mujore e shkarkimeve të SO_2 nga të gjitha impiantet e djegies në rafineri, pavarësisht nga lloji i lëndës djegëse ose kombinime të lëndës djegëse të përdorur, por përjashtuar impiantet që përfshihen në shkronjat "a" ose "b", të kësaj pike, si edhe për turbinat e gazit dhe motorët me gaz, nuk e kalon vlerën 1 700 mg/Nm^3 për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara prej 3%, në kushte të thata.

4. Në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit, duke filluar nga data 1 janar 2028, në varësi të monitorimeve përkatëse të shkarkimeve në ajër nga autoritetet kompetente, pika 2, e këtij kreu, nuk zbatohet për lëndët djegëse të lëngëta, të rënda, që përdoren:

a) në impiantet me djegie, me fuqi më të madhe ose të barabartë me 50 mw, të cilat respektojnë vlerat kufi të shkarkimeve të SO_2, ose në rastin kur vlerat kufi të shkarkimeve të SO_2 nuk janë të zbatueshme, mesatarja mujore e shkarkimeve të dyoksidit të squfurit nuk e kalon vlerën 1 700 mg/Nm^3, për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara prej 3%, në kushte të thata;

b) në impiantet me djegie që nuk bëjnë pjesë në shkronjën "a", të kësaj pike, dhe për të cilat mesatarja mujore e shkarkimeve të dyoksidit të squfurit nuk e kalon vlerën 1 700 mg/Nm^3, për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara 3%, në kushte të thata;

c) për djegie në rafineri, kur vlera mesatare mujore e shkarkimeve të SO2 nga të gjitha impiantet e djegies në rafineri, pavarësisht nga lloji i lëndës djegëse ose kombinime të lëndës djegëse të përdorur, por përjashtuar impiantet që përfshihen në shkronjën "a", të kësaj pike, si edhe për turbinat e gazit dhe motorët me gaz, nuk e kalon vlerën 1 700 mg/Nm^3 për një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara prej 3%, në kushte të thata.

5. Ministria përgjegjëse për mjedisin nuk lejon operimin e impianteve me djegie, të cilët përdorin lëndë djegëse të lëngëta, të rënda (mazut) me përqendrim të squfurit më të lartë se 1%, nëse në lejen e tyre të mjedisit nuk janë specifikuar vlerat limite për shkarkimet e gazeve të SO_2.

KREU III
PËRMBAJTJA MAKSIMALE E SQUFURIT NË LËNDËT DJEGËSE TË LËNGËTA, TË MESME, TË RËNDA

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas datës 31 dhjetor 2019, lejohet vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta, të mesme, të rënda dhe të gazit të lëngët të naftës (GLN), si lëndë djegëse për përdorim termik, civil dhe industrial që në nomenklaturën e mallrave përshkruhen me kodet: CN 27111294, CN27111391, CN27111397 (gaz i lëngët), CN 2710 19 25 (vajguri), CN 2710 19 29 (lëndëve djegëse të lëngëta, fraksione të mesme), CN 2710 19 47; CN 2710 19 48; CN 2710 20 17; CN 2710 20 19, që plotëson kërkesat e standardit shqiptar SSH EN 589 , SSH ISO 9162 dhe SSH UNI 6579, ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me të, siç parashikohet në shtojcat 1 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përmbajtja e squfurit, në lëndët djegëse të lëngëta, të mesme, të rënda, pas datës 31 dhjetor 2019 nuk duhet të kalojë 0,10% ndaj masës.

3. Përmbajtja totale e squfurit në gazet e lëngëta të naftës, duke filluar nga data 1 janar e vitit 2020, nuk lejohet të kalojë 50 mg/kg, ndërsa tensioni i avujve të jetë respektivisht jo më shumë se 1 000 kpa për përdorim rezidencial dhe 1 300 kpa për automjete.

KREU IV
PËRMBAJTJA MAKSIMALE E SQUFURIT NË LËNDËT DJEGËSE TË LËNGËTA DETARE, QË PËRDOREN NGA ANIJET NË UJËRAT TERRITORIALE TË SHQIPËRISË, NË ZONAT EKSKLUZIVE EKONOMIKE DHE NË ZONAT E KONTROLLIT TË NDOTJES, PËRFSHIRË ZONAT E KONTROLLIT TË SOx DHE NGA ANIJET E PASAGJERËVE

1. Në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm tregtimi i gazit të lëngët të naftës, të lëndëve djegëse të lëngëta detare, për qëllim përdorimi në mjete të transportit ujor, që plotësojnë kërkesat e standardit shqiptar SSH ISO 8217 ose të standardeve të tjera, të barasvlershme me të, me përjashtim të kushtit për përmbajtjen e squfurit, siç parashikohet në shtojcat 3 dhe 4, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas datës 31 dhjetor 2019, nuk lejohet përdorimi i lëndës djegëse të lëngët detare, nëse përmbajtja e squfurit tejkalon vlerën 1% në masë, me përjashtim të rastit kur anijet përdorin metoda të uljes së përmbajtjes së squfurit, duke operuar me metodën e mbyllur, sipas përcaktimit në kreun VI, të këtij vendimi.

3. Pavarësisht parashikimit të pikës 2, të këtij kreu, pas datës 31 dhjetor 2020, lëndët djegëse të lëngëta detare nuk përdoren në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes, nëse përmbajtja në masë e squfurit në këto lëndë djegëse tejkalohet me 0.5% (5g/kg).

4. 12 muaj pas datës së përcaktimit të zonave të reja detare nga IMO-ja, përfshirë portet si edhe zonat e kontrollit të shkarkimeve të SO_2, në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes që bien brenda zonave të kontrollit të emetimeve të SO_2, nuk lejohet përdorimi i lëndëve djegëse të lëngëta detare (*marine fuel*) nëse përmbajtja në masë e squfurit në to tejkalohet me 0.1% (1g/kg).

Kërkesat e pikave 3 dhe 4, të këtij kreu, zbatohen për të gjitha anijet, pavarësisht nga flamuri që përfaqësojnë, përfshirë anijet, udhëtimi i të cilave fillon jashtë Shqipërisë.

5. Anijet e pasagjerëve që lundrojnë në linja të rregullta për ose nga ndonjë port i Shqipërisë, nuk lejohen të përdorin lëndë djegëse të lëngëta detare në ujërat territoriale të Shqipërisë, në zonat ekskluzive ekonomike dhe në zonat e kontrollit të ndotjes që bien jashtë zonave të kontrollit të emetimeve të SO_2, nëse përmbajtja e squfurit në to tejkalon 1% m / m, deri në datën 31 dhjetor 2020.

Kërkesat e kësaj pike zbatohen për të gjitha anijet në portet e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga flamuri që përfaqësojnë.

6. Personat përgjegjës në anije krijojnë dhe mbajnë regjistrin (*logbooks*) e lëndëve djegëse detare të përdorura në anije, duke përfshirë edhe operacionet e ndërrimit të këtyre lëndëve.

7. Autoritetet shtetërore shqiptare/MIE përpiqen të sigurojnë disponueshmërinë e lëndëve djegëse të lëngëta detare, të cilat janë në

përputhje me dispozitat e këtij vendimi dhe të informojnë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për disponueshmërinë e tyre në portet dhe terminalet e saj.

8. Deri në datën 31 dhjetor 2019, në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta diezel detare, përmbajtja e squfurit në të cilat nuk tejkalon 1% m/m (10g/kg).

KREU V
PËRMBAJTJA MAKSIMALE E SQUFURIT NË LËNDËT DJEGËSE TË LËNGËTA DETARE QË PËRDORET NË MJETE TË TRANSPORTIT DETAR QË ANKOROHEN NË PORTET E SHQIPËRISË

1. Anijet që ankorohen në portet e Shqipërisë nuk duhet të përdorin lëndë djegëse detare me përmbajtje squfuri që tejkalon 0.1% m / m, duke i lejuar stafit të anijes kohën e nevojshme për plotësimin e operacioneve të duhura për ndërrimin e lëndës djegëse dhe regjistrimin në regjistër (*logbooks*) të kohës së shpenzuar për ndërrimin e lëndës djegëse.

2. Kërkesat e kësaj pike nuk zbatohen për:

a) anijet, të cilat sipas orarit të publikuar, qëndrojnë më pak se 2 (dy) orë në port;

b) anijet të cilat fikin motorët dhe furnizohen me energji elektrike nga territori.

3. Në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas datës 31 dhjetor 2020 lejohet vetëm tregtimi i lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda detare, në të cilat përmbajtja e squfurit nuk tejkalon 0.1% m/m (1g/kg).

KREU VI
METODAT E REDUKTIMIT TË SHKARKIMEVE NË AJËR NË BORDIN E ANIJEVE DHE MIRATIMI I TYRE

1. Të gjitha anijet në portet shqiptare, në ujërat territoriale shqiptare, në zonat ekonomike ekskluzive dhe në zonat e kontrollit të ndotjes, pavarësisht nga flamuri që përfaqësojnë, të cilat përdorin lëndëve djegëse detare që nuk plotësojnë standardet e referuara në krerët IV e V të këtij vendimi, detyrohen të përdorin metoda alternative të reduktimit të shkarkimeve të SO2 në ajër.

2. Anijet të cilat përdorin metoda alternative për reduktimin e shkarkimeve të ndotësve në ajër, reduktojnë në vazhdimësi shkarkimet e SO2 në vlera të tilla, të cilat janë ekuivalente me reduktimin që do të ndodhte nëse do të përdorej lëndë djegëse detare që plotëson kushtet e përcaktuara në krerët IV dhe V, të këtij vendimi. Ekuivalenca e vlerave të shkarkimeve të substancave ndotëse në ajër përcaktohet në përputhje me shtojcën 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet inspektuese inkurajojnë përdorimin e sistemeve të furnizimit me energji nga anijet e ankoruara si metodë alternativë për reduktimin e shkarkimeve.

4. Për zbatimin e metodave të reduktimit të përmendura në pikën 1, të këtij kreu, do të përdoren kriteret e paraqitura në shtojcën 6, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Metodat e reduktimit të shkarkimeve miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin. Hartimi i tyre kryhet në përputhje me:

a) instrumentet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me pajisjet e certifikuara që vendosen në bordet e anijeve;

b) udhëzuesit e zhvilluar nga IMO-ja;

c) efektet në mjedis, duke përfshirë reduktimin e pritshëm të shkarkimeve dhe ndikimet në ekosistemet në portet e mbyllura, limanet dhe estuaret; dhe

ç) mundësitë e monitorimit dhe verifikimit.

KREU VII
NDRYSHIMET NË FURNIZIMIN ME LËNDË DJEGËSE

1. Nëse, si rezultat i një ndryshimi të papritur, në furnizimin e vendit me naftë të papërpunuar, produkte të naftës dhe hidrokarbure të tjera (ndërprerje e tregut), bëhet e vështirë për të aplikuar kufizime për përmbajtjen maksimale të squfurit referuar në krerët II, III, IV dhe V, të këtij vendimi, ministria përgjegjëse për hidrokarburet, pas marrjes së miratimit prej Këshillit të Ministrave të shprehur nëpërmjet vendimit përkatës, për këtë situatë informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, në Vjenë.

2. Procedimi i mëtejshëm për trajtimin e situatave që lidhen me ndryshim të papritur, në furnizimin e vendit me naftë të papërpunuar, produkte të naftës dhe hidrokarbure të tjera (ndërprerje e tregut), bëhet në bashkërendim me institucionet e Komunitetit të Energjisë, në përputhje dhe respektim të të drejtave e detyrimeve, që burojnë nga nenet 47 e 67, të traktatit për krijimin e Komunitetit të Energjisë.

KREU VIII
KONTROLLI I CILËSISË SË LËNDËS DJEGËSE DHE RAPORTIMI

1. Institucionet përgjegjëse për kontrollin e standardeve të cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta në tregun e naftës dhe të nënprodukteve të saj, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të ushtruar kontrolle lidhur me respektimin e përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngshme për përdorim termik civil dhe industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor, për të qenë në përputhje me përcaktimet në krerët II, III, IV dhe V, të këtij vendimi.

2. Nëse konstatohet se një anije nuk plotëson standardet e cilësisë së lëndës djegëse, kontrolli nga ISHTI-ja konsiston në:

a) kontrollin e regjistrave (*logbooks*) me veprimet e ndërmarra në përpjekje për të arritur përputhshmërinë dhe notën e lëshuar nga furnizuesi për të paktën 10% të numrit total të anijeve që lundruan në /nga portet shqiptare të hapura për trafikun ndërkombëtar gjatë 1 viti;

b) kontrollin e dokumentacionit për prokurimin e lëndëve djegëse të lëngëta, analizën e mostrave të vulosura të lëndës djegëse që digjet në anije ose marrjen e mostrave të karburantit për analizë në një objekt lundrues (notë e lëshuar nga furnizuesi);

c) kontrollin e cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta detare për përmbajtjen e squfurit, për të paktën 30% të anijeve nga 10% e numrit mesatar të anijeve që lundruan në/nga portet shqiptare të hapura për trafikun ndërkombëtar në tri vitet e fundit;

ç) kontrollin e cilësisë së lëndëve djegëse të lëngëta detare edhe gjatë shpërndarjes, nëse furnizuesi i karburantit ka furnizuar lëndë djegëse së paku tre herë gjatë vitit kalendarik të kaluar, cilësia e të cilave nuk është në përputhje me notën e lëshuar.

3. Anijes nuk i kërkohet të devijojë nga udhëtimi i saj i synuar ose të shtyjë në mënyrë të padrejtë udhëtimin për të arritur përputhshmërinë me lëndën djegëse.

4. Nëse një anije siguron informacionin e përmendur në pikën 2, të këtij kreu, institucioni përgjegjës për kontrollin/ISHTI merr parasysh të gjitha rrethanat përkatëse dhe provat e paraqitura për të përcaktuar masat që duhen marrë, duke përfshirë edhe mosmarrjen e masave të kontrollit.

5. Anijet njoftojnë shtetin, flamurin e të cilit përfaqësojnë, ose autoritetet kompetente të portit të destinacionit nëse nuk arrijnë të sigurojnë lëndën djegëse detare të kërkuar, sipas dispozitave të këtij vendimi.

6. Ministria përgjegjëse për hidrokarburet njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, lidhur me anijet që kanë paraqitur dëshmi për mosdisponueshmërinë e lëndëve djegëse detare.

7. Marrja e mostrave, kryerja e analizave, si dhe testimi i çdo treguesi fiziko-kimik të lëndëve djegëse të lëngshme të përmendura në krerët II, III, IV dhe V, të këtij vendimi, të bëhet sipas metodave të analizave të referuara në këtë vendim dhe të përcaktuara në standardet përkatëse në fuqi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve.

8. Përveç parashikimit në pikën 7, të këtij kreu, marrja e mostrave (frekuenca dhe sasia) gjatë furnizimit të anijes me lëndë djegëse të lëngëta detare që përdoren për djegie në bord, nga tanket kur është e mundur teknikisht dhe ekonomikisht si edhe në bordin e anijes nga mostrat e mbyllura të lëshuara nga furnizuesi kryhet në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për energjinë për marrjen e mostrave dhe raportimin e lëndëve djegëse, përfshirë ato të lëngëta detare.

9. Testi i përmbajtjes së squfurit për lëndët djegëse të lëngëta detare kryhet në përputhje me metodat nga standardet e mëposhtme: ASTM D 4294 ose SSH EN ISO 20847.

10. Në rast të mosmarrëveshjes për saktësinë e rezultateve të testimit, vlerësimi i analizave të lëndëve djegëse të furnizuara rregullohet nga dispozitat e SSH EN ISO 4259.

11. Për të përcaktuar nëse lënda djegëse e shpërndarë apo përdorur në bordin e anijes është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në krerët IV dhe V, të këtij vendimi, përdoren metodat e verifikimit të përcaktuara në shtojcën VI të MARPOL-it.

12. Ngarkohen ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Turizmit dhe Mjedisit që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojnë udhëzimin e përbashkët për marrjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave, për cilësinë e gazit të lëngët të naftës (GLN), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda, lëndëve djegëse të lëngëta detare dhe furnizuesit e këtyre lëndëve djegëse të lëngëta.

KREU IX
SANKSIONET

1. Nëse pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi evidentohen subjekte që tregtojnë lëndë djegëse të lëngëta, me cilësi, që nuk respektojnë kërkesat e këtij vendimi:

a) për treguesit tekniko-cilësorë që nuk janë brenda vlerave të lejuara sipas standardeve në fuqi, zbatohen sanksionet e parashikuara në nenin 25, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar;

b) për treguesit tekniko-cilësorë që ndryshojnë dhe nuk janë brenda vlerave të lejuara sipas standardeve në fuqi, lëndët djegëse të lëngëta sekuestrohen, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 10279/2010, "Për kundërvajtjet administrative".

2. Sekuestrimi i lëndëve djegëse të lëngshme dhe përcaktimi i destinacionit të produkteve të sekuestruara bëhet nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, në përputhje me procedurat e përcaktuara në një udhëzim të përbashkët të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë, i cili duhet të dalë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

KREU X
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë që të nxjerrin udhëzimet në zbatim të përcaktimeve të pikës 5, të kreut VI; të pikës 8, të kreut VIII; të pikës 12, të kreut VIII; si edhe të pikës 2, të kreut IX, të këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 781, datë 14.11.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)", shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA 1
TREGUESIT E LEJUAR MJEDISORË PËR LËNDËT DJEGËSE (VAJGURI-GAZOIL) PËR PËRDORIM TERMIK, CIVIL DHE INDUSTRIAL

Lloji i lëndës djegëse	Njësia	Vajguri (kerosinë)	Gazoil < 0.1	Gazoil > 0.1
	Njësia	A	B	C
Pika e flakërimit	^{0}C	≥28	>55	>52
Masa vëllimore në 15 ^{0}C	Kg/m^3	770-830	815-875	815-875
Distilimi				
në 150 ^{0}C	% v/v	-	<2	<2
në 210 ^{0}C	% v/v	<90		
në 250 ^{0}C	% v/v	>65	<65	
në 300 ^{0}C	% v/v			<60
në 350 ^{0}C	% v/v		>85	<85
Nikel + vanad	mg/kg			
PCB (policlorbifenil)	mg/kg	<15	<15	<15
PCT(policlortrifenil)	mg/kg	<10	<10	<10
Ngjyrat(1)		po	po	po
Shënim(1): është e detyrueshme ngjyrosja për produktet ABC sipas ligjeve dhe akteve ligjore në fuqi				

SHTOJCA 2
TREGUESIT E LEJUAR MJEDISORË PËR LËNDËT DJEGËSE (DISTILATE TË RËNDA NGA NAFTA) PËR PËRDORIM CIVIL TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Lloji i lëndës djegëse	Njësia	Lëndë djegëse të rënda të naftës (*heavy fuel oil*)	
		solar	mazut
	Njësia	D	E
Pika e flakërimit	^{0}C	>65	>80
Hiri	% (m/m)	<0.1	<0.1
Squfuri	%(m/m)	<0.1	<1
Nikel +Vanad	mg/kg	<180	<180
PCB (policlorbifenil)	mg/kg	<4	<4
PCT(policlortrifenil)	mg/kg	<10	<10
Fuqia kalorifike	Mj/kg	>40	>40

SHTOJCA 3
TREGUESIT MJEDISORË PËR LËNDËT DJEGËSE DETARE (*MARINE FUEL*)

Treguesit	Njësia e matjes	Limitet	Produkti			
			DMX	DMA	DMZ	DMB
Masa vëllimore në 15 ^{0}C	Kg/m^3	Max.	-	890.0	890.0	900.0
Pika e flakërimit	^{0}C	min	43	60	60	60
Indeksi i cetanit	-	min.	45	40	40	35
Përmbajtja e squfurit	%(m/m)	max.	1.00	1.00	1.00	1.5
Përmbajtja e H_2S (hidrogjeni i sulfuruar)	mg/kg	max	2.00	2.00	2.00	2.00
Mbetje karboni (metoda e mikro 10% volum mbetje distilimi)	%(m/m)	max	0.3	0.3	0.3	-

SHTOJCA 4
TREGUESIT E CILËSISË PËR GAZIN E LËNGËZUAR QË PËRDORET PËR AUTOMJETE DHE QËLLIME REZIDENCIALE

Përbërësit dhe treguesit e cilësisë	**Njësia**	**GLN për automjete**		**GLN për përdorim termik dhe civil**	
		min	**max**	**min**	**max**
Numri i oktanit motorik, NOM		89	-	-	-
Përmbajtja totale e dieneve (përfshirë 1,3 butadien)	% mol	-	0.5	-	0.5
Përmbajtja e sulfurit të hidrogjenit		negativ	negativ	negativ	negativ
Përmbajtja e përgjithshme e squfurit (pas erës së keqe)	mg/kg	-	50	-	50
Mbetje pas avullimit	mg/kg		60		60
Tensioni i avujve, manomatrik, në 40 ^{0}C	kPa		1300		1000
Tensioni i avujve, manometrik, min temperature prej :	kPa	150		150	
Për klasën A	^{0}C		-10		-10
Për klasën B			-5		-5
Për klasën C			0		0
Për klasën D			10		10
Për klasën E			20		20
Përmbajtja e ujit		kalon			Kalon
Aroma e pakëndshme dhe e dallueshme				Në 20% të KUN-së	

SHTOJCA 5
METODA E PËRCAKTIMIT TË VLERËS EKUIVALENTE TË SHKARKIMEVE NË ATMOSFERË

Vlerat ekuivalente të emetimeve të ndotësve në ajër jepen në tabelën 1 të kësaj shtojce.

Tabela 1

Përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse detare	**Pjesa e shkarkimeve SO_2 (ppm) CO_2 (% v/v)**
3,50	151,7
1,50	65,0
1,00	43,3
0,50	21,7
0,10	4,3

Vlerat e emetimeve ekuivalente zbatohen vetëm për përdorimin e naftës dhe motorëve të naftës.

Kur përqendrimi i CO_2 zvogëlohet nga pajisja për pastrimin e gazit (EGC), përqendrimi i CO_2 mund të matet

hapja hyrëse e pajisjes, me kusht që korrektësia e një metodologjie të tillë të mund të demonstrohet.

SHTOJCA 6
KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E METODAVE TË REDUKTIMIT TË SHKARKIMEVE TË SQUFURIT

Metoda e reduktimit të shkarkimeve të përmbajtjes së ndotësve në ajër përfshin përdorimin e pajisjeve, materialeve, dhe pajisjeve që janë instaluar në anije, dhe përdorimi i karburantit alternativ në përputhje me këtë vendim.

1. Kriteret për përdorimin e motorëve me dy karburant (një përzierje e karburantit detar dhe gazit të avulluar)

Anijet e gazit natyral të lëngëzuar mund të përdorin një përzierje të karburantit detar dhe të gazit të avulluar, me kusht që ato të arrijnë një reduktim të vazhdueshëm të emetimeve oksid squfuri (VI) ekuivalent me atë të fituar duke përdorur karburantin me sulfur të ulët të përshkruar në këtë Vendim.

Ekuivalenca e reduktimeve të emetimeve është llogaritur duke përdorur formulat e mëposhtme:

$$S_k(\%) \cdot M_k \leq 0{,}1\ \% \cdot M_{k0{,}1\%}$$

ku:

-M_{SHGA}: masa e shpenzuar e gazit avullon

- V_{EGA}: vlera e energjisë e gazit të avulluar në MJ / kg,

- M_K: masa e karburantit të konsumuar në kilogram,

- E_K: vlera e energjisë e karburantit detar në MJ / kg.

- E_K 0.1%: vlera e energjisë e karburantit detar me përmbajtje të squfurit ≤ 0.1% në MJ / kg

Formulat e përmendura në paragrafin 2 të kësaj Shtojce mund të kombinohen në mënyrën e mëposhtme:

$S_k(\%) \cdot M_k/(M_{SHGA} \cdot V_{EGA} + M_k \cdot E_k)/\leq 0{,}1\%/ E_{k0{,}1\%}$

$S_k(\%)/(R_{G/k} \cdot V_{EGA} + E_k) \leq 0{,}1\%/ E_{k0{,}1\%}$

ku:

- R G / K: raporti midis masës së gazit të avulluar dhe karburantit detar (M_{SHGA} / M_K)

Duke pasur parasysh se vlerat e energjisë e karburantit të ndryshme detare, e cila është përdorur në formulë është shumë e ngjashme, është e arsyeshme që të përdorin vlerat e përzgjedhura për Ek0,1%, Ek dhe $V_{EGA.}$

Zbatimi i kësaj formule në praktikë:

$E_{k0{,}1\%}$ = 43,0 MJ/kg

E_k = 40,8 MJ/kg

V_{EGA} = 50,0 MJ/kg

Kjo formulë mund të shprehet:

$$R_{G/k} \geq 8{,}6 \cdot S_k(\%) - 0{,}816$$

Raporti minimal i nevojshëm i përzierjes së lëndës djegëse detare dhe gazit të avulluar për të përmbushur kriteret për arritjen e reduktimit të emetimeve të squfurit (VI) për lëndët djegëse detare me përmbajtje të ndryshme të squfurit është dhënë në tabelë:

Përmbajtja e squfurit (%)	1,0	1,5	2,0	2,5	3,0	3,5
$R_{G/k}$ (M_{SHGA} /M_k)	7,8	12,1	16,4	20,7	25,0	29,3

2. Kriteret për përdorimin e sistemit të pastrimit të shkarkimit të gazit

Sistemet e pastrimit të shkarkimit të gazit duhet të instalohen në sistemet e djegies e një anije, me përjashtim të disa anijeve, me kushtin që:

- përdorimi i një sistemi të jetë miratuar në bazë të matjeve periodike të shkarkimeve ose sistemi është i pajisur me një pajisje për matjen e vazhdueshme të shkarkimeve të ndotësve në ajër;

- ekuivalenca e vlerave të emetimit në lidhje me përdorimin e lëndëve djegëse me sulfur të ulët, në bazë të raportit të oksideve të squfurit

(IV) dhe oksideve të karbonit (IV) në gazin shkarkues (SO_2 (ppm) / CO2 (%)), në përputhje me shtojcën 3 të këtij vendimi;

- një drenazh për shkarkimin e ujit nga një sistem pastrimi i gazit të shkarkimit në mënyrë që të shmanget shkaktimi i korrozionit të komponentëve metalikë të enëve;

- uji i shpëlarjes nga sistemi i shkarkimit që do të lirohet në det ka pH jo më të madhe se 6.5, përmbajtja e hidrokarbureve aromatike policiklike që nuk tejkalon 50 µg / l, përmbajtja e NOx jo më shumë se 60 mg / l me një normë rrjedhjeje prej 45 t / MËh;

- sistemi i pastrimit të gazit të shkarkimit ka një udhëzim teknik nga prodhuesi që tregon pajisjen e identifikimit të pajisjes (modeli / tipi, numri i serisë), përshkrimi i sistemit dhe lidhja pajisjet, stabilimentet e propulsionit, karakteristikat e motorit dhe lloji i karburantit për të cilin përdoret sistemi i pastrimit të gazit të shkarkimit, rrjedha maksimale dhe minimale dhe alkaliniteti i ujit për rryma, temperatura dhe presioni i shkarkimit të gazit kur sistemi është në veprim, niveli i kripshmërisë së ujit të detit është i nevojshëm për neutralizimin e komponentëve të ndihmës së shpëlarjes dhe parametrave të tjerë relevante për arritjen e vlerës kufitare të shkarkimeve të ndotësve në ajër;

Shpëlarja e ujit nga sistemi i pastrimit të gazrave të shkarkimit duke përdorur kimikate, shtesa, preparate dhe kimikate nuk derdhet në det, duke përfshirë portet e mbyllura, skelë dhe estuaret, përveç nëse dërguesi vërteton që shkarkimi i një ujësie të tillë nuk ka efekte të konsiderueshme negative dhe nuk paraqet rrezik për shëndetin e njeriut ose mjedisin.

Kur sistemet e pastrimit të gazit janë në veprim ndërsa Anija është në port, monitorimi i ujit të shpëlarjes që lëshohet në det bëhet vazhdimisht, në mënyrë që pH, përmbajtja e hidrokarbureve policiklike aromatike, vërshimi dhe temperatura e ujit monitorohen dhe regjistrohen.

Sistemet e pastrimit të gazit të shkarkimit të instaluara në motorin kryesor sigurojnë pajtueshmëri me vlerat kufi të shkarkimeve në ngarkesat e motorit nga 25% në 100%.

Sistemet e pastrimit të gazit shkarkues të instaluar në motorët ndihmës të naftës dhe motorët me naftë që sigurojnë energji për makinën sigurojnë që vlerat kufi të shkarkimit të respektohen me ngarkesën e motorit nga 10% në 100%.

3. Kriteret për përdorimin e biokarburanteve

Biokarburantet mund të përdoren në Anije në qoftë se plotësojnë kërkesat e përcaktuara me një vendim të veçantë.

Përzierjet e biokarburanteve dhe lëndëve djegëse detare mund të përdoren në objekte detare nëse plotësojnë vlerat kufi të përmbajtjes së squfurit të përshkruar në këtë vendim.

UDHËZIM
Nr. 481, datë 27.6.2019

PËR PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin nr. 27/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 4.7.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor",

UDHËZOJ

KREU 1
TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim rregullon procedurat për punësimin e profesionistëve të shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike.

2. Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve, si dhe emërimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit "Infermier për Shqipërinë".

3. Portali "Infermier për Shqipërinë" është një mekanizëm i ngritur për punësimin e teknikëve të shkencave mjekësore në bazë meritokracie duke

siguruar transparencë, efikasitet dhe shanse të barabarta.

4. Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (në vazhdim "DQOSHKSH") është institucioni përgjegjës për procedurat e konkurrimit dhe të pranimit të profesionistëve të shkencave mjekësore në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore publike, ndërsa drejtoritë rajonale të shërbimeve të kujdesit shëndetësor (në vazhdim "DROSHKSH") organizojnë procedurat sipas këtij udhëzimi.

5. Thirrja për konkurrim shpallet sipas profileve për profesionistët e shkencave mjekësore teknike, mbi bazë të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (në vijim "NJVKSH") duke përfshirë dhe spitalet respektive.

6. Procesi i konkurrimit për profesionistët e shkencave mjekësore teknike, zhvillohet për:

a) të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për ushtrimin e profesionit;

b) kandidatët që kanë marrë pjesë në testimin "Infermierë për Shqipërinë" të thirrjes paraardhëse dhe që dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e tyre.

7. DROSHKSH-ja ka detyrimin të raportojë në DQOSHKSH lëvizjet paralele dhe vendet e lira të punës në 2 (dy) ditët e para të çdo muaji.

8. DQOSHKSH-ja ka detyrimin të shpallë në portalin "Infermier për Shqipërinë" përgjatë gjithë vitit, vendet e lira të punës për çdo institucion shëndetësor publik, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji.

9. Shpallja në portalin "Infermierë për Shqipërinë" përmban këto të dhëna:

a) fushën kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe dokumentet që do të vlerësohen në konkurrim;

b) fazat në të cilën do të kalojë konkurrimi, vlerësimi i dosjes dhe testimi i informatizuar;

c) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;

d) afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;

e) datën e daljes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve;

f) mënyrën e vlerësimit të kandidatëve në fazën e vlerësimit të dosjes, si dhe në fazën e testimit të informatizuar;

g) mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

10. Regjistrimi i kandidatëve bëhet vetëm nëpërmjet internetit në portalin "Infermierë për Shqipërinë". Të interesuarit do të kenë si afat për kryerjen e aplikimit të paktën dy javë kalendarike nga data e shpalljes.

11. Dokumentacioni duhet të dërgohet brenda afatit të caktuar në ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes në portalin "Infermierë për Shqipërinë", si dhe një kopje me postë ose dorazi të protokollohet pranë DROSHKSH-së përkatëse, sipas përcaktimit në shpalljen për konkurrim.

KREU 2
KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. DQOSHKSH-ja krijon komisionet e vlerësimit në nivel rajonal (sipas ndarjes të katër drejtorive rajonale të operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor).

2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) 2 (dy) anëtar nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, kryetar i komisionit është drejtori i DROSHKSH-së;

b) 1 (një) anëtar nga Drejtoria Qendrore e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;

c) (dy) anëtarë nga institucionet shëndetësore, të paktën njëri të jetë në profilet e shkencave teknike mjekësore.

3. Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në DROSHKSH, kryen rolin e sekretarit teknik për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

4. Komisioni i Vlerësimit kryen detyrat si më poshtë:

a) administron dosjet e aplikantëve që kanë aplikuar në portalin "Infermier për Shqipërinë";

b) vlerëson dokumentacionin e dosjes së çdo kandidati, sipas kritereve të vlerësimit të përcaktuara në këtë udhëzim;

c) evidenton kandidatët që u mbarten pikët, si dhe rastet kur kandidatët sjellin dokumente shtesë në dosjen e tyre;

d) shqyrton ankesat e kandidatëve për vlerësimin e marrë;

e) përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar;

f) bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra në secilën fazë të vlerësimit dhe ato në total në përfundim të vlerësimit;

g) dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DQOSHKSH dhe në MSHMS listën me pikët për çdo kandidat.

5. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit duhet të verifikojnë dhe të shmangin konfliktin e interesit me kandidatët.

KREU 3
PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi i kandidatëve përfshin:

a) Vlerësimin e dosjes së kandidatëve që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 30 pikë;

b) vlerësimi i testit të informatizuar, deri në 70 pikë;

3/1 KONKURRIMI ME DOSJE

1. Në fazën e parë, kandidatët e interesuar regjistrohen në portalin "Infermierë për Shqipërinë".

2. Jetëshkrimi standard dhe dokumentet e tjera të parashikuara në shpallje, dërgohen nëpërmjet internetit në portalin "Infermierë për Shqipërinë", ku gjenden edhe udhëzimet përkatëse, si dhe një kopje me postë ose dorazi protokollohet pranë DROSHKSH-së përkatëse, sipas përcaktimit në shpalljen për konkurrim.

3. Dokumentet e aplikimit për profesionistët e shkencave mjekësore teknike që duhet të hidhen në portal në momentin e aplikimit janë:

a) *Curriculum Vitae* sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi;

b) fotokopje e diplomave dhe lista e notave për çdo diplomë (e detyrueshme);

c) fotokopje e lejes së ushtrimit të profesionit (e detyrueshme);

d) fotokopje e librezës së punës (nëse ka);

gj) vërtetim për gjendjen gjyqësore (e detyrueshme në momentin e fillimit të detyrës);

e) raporti mjeko-ligjor i tre muajve të fundit (i detyrueshëm në momentin e fillimit të detyrës);

f) Deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit shëndetësor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura (sipas shtojcës nr. 2).

4. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme si më sipër, skualifikohet.

5. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve, përcaktohet në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Kandidatët kanë të drejtë, që në një thirrje për aplikim, të konkurrojnë vetëm për një rajon, brenda të cilit do të mund të përzgjedhin, deri në tre NJVKSH.

7. Kandidati i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe ka dokumentacion shtesë, i depoziton ato pranë Komisionit të Vlerësimit kur hapet portali i radhës, Komisioni i Vlerësimit mban procesverbal dhe shton pikët e kandidatit. Kandidati i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e mëparshëm dhe dëshiron të marrë pjesë në testim, do të renditet në listën përfundimtare me pikët e testimit të fundit. Kandidati i cili nuk paraqet dokumente shtesë pranë komisionit dhe nuk dëshiron të marrë pjesë në testimin e radhës, i mbarten pikët ekzistuese në renditjen e re deri në dy vjet.

8. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit firmosin deklaratën për pajtueshmërinë me ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas shtojcës nr. 4.

9. Komisioni i Vlerësimit pasi administron dosjet e kandidatëve, brenda dhjetë ditë pune pas përfundimit të afatit të pranimit të aplikimeve, vlerëson dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët dhe harton listën për çdo profil sipas çdo NJVKSH, renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës.

10. Komisioni i Vlerësimit, i dërgon DQOSHKSH-së listën e përgatitur si më sipër, për ta publikuar në Portalin "Infermier për Shqipërinë".

11. Në të njëjtën ditë që publikohet lista, Komisioni i Vlerësimit njofton me e-mail kandidatët që nuk janë kualifikuar për arsyen e moskualifikimit.

12. Kandidatët kanë të drejtën e ankimimit në adresën e portalit ose në adresën me të cilën marrin njoftimin, brenda tre ditëve nga dita e shpalljes lidhur me vlerësimin e dosjes. Komisioni i vlerësimit brenda pesë ditë pune shqyrton ankesën, i kthen përgjigje ankimuesit dhe reflekton ndryshimin e pikëve nëse ankesa ka qenë e drejtë.

3/2 TESTIMI I INFORMATIZUAR

1. Në fazën e dytë, "Testimi i informatizuar", marrin pjesë kandidatët që kanë kaluar me sukses fazën e parë të vlerësimit me dosje. Në testim marrin pjesë dhe kandidatët që janë në listë pritje dhe dëshirojnë të përmirësojnë rezultatin e testimit të mëparshëm. Kandidatët që dëshirojnë të marrin pjesë në testim për të përmirësuar pikët e mëparshme, regjistrohen pranë drejtorisë rajonale përkatëse vetëm për testimin e informatizuar.

2. DQOSHKSH-ja përgatit listat e kandidatëve që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar dhe ia dërgon në formë elektronike dhe me shkrim Qendrës së Shërbimeve Arsimore, në përputhje me rregullat e kësaj qendre.

3. Pyetjet e testit të vlerësimit hartohen në bazë të secilit profil të shpallur, nga pedagogët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike të Universitetit të Mjekësisë Tiranë. Kalendari i testimit publikohet në portalin "Infermier për Shqipërinë".

4. Rezultatet e testimit të informatizuar i kalojnë DQOSHKSH-së, e cila bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale, që nxirret nga shuma e pikëve të marra në vlerësimin e dosjes së aplikimit dhe pikëve të marra në testimin e informatizuar. Renditja fillon me kandidatin me më shumë pikë dhe vijon në rend zbritës. Lista publikohet në portalin "Infermierë për Shqipërinë".

5. Në fund të procedurës së vlerësimit kandidati konsiderohet fitues nëse ka marrë mbi 40 pikë.

KREU 4
PROCEDURA E ZGJEDHJES SË VENDIT TË PUNËS DHE EMËRIMI I PROFESIONISTËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

1. NJVKSH-ja, si dhe qendrat spitalore identifikojnë vendet e lira të punës (parësor dhe spitalor) që krijohen dhe i raportojnë tek DROSHKSH-ja përkatëse brenda 2 (dy) ditëve nga data e krijimit të vakancës. Qendrat Spitalore Universitare raportojnë vendet e lira të punës pranë DROSHKSH Tiranë. DROSHKSH-të raportojnë vendet vakant të krijuara pranë DQOSHKSH-së, e cila i shpall ato në portal menjëherë.

2. Renditja përfundimtare e kandidatëve fitues administrohet nga DQOSHKSH-ja dhe shpallet në portalin "Infermier për Shqipërinë" dhe në faqen elektronike zyrtare të saj.

3. Për vendet e lira të punës për çdo NJVKSH, kandidati njoftohet nga DROSHKSH-ja, në varësinë e të cilës është vendi vakant, përmes postës elektronike të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit on-line dhe në dosje.

4. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme sipas NJVKSH-ve, është renditur me numrin më të madh të pikëve në profilin që ka aplikuar, ka të drejtën e zgjedhjes për vendet e lira të punës në institucionet shëndetësore të NJVKSH-së përkatëse dhe është i detyruar të konfirmojë në DROSHKSH brenda 24 orëve në adresën elektronike. Në rast se DROSHKSH-ja nuk merr konfirmim nga kandidati brenda këtij afati, atëherë vendi vakant i ofrohet kandidatit të radhës. Kandidati që nuk konfirmon pranimin e pozicionit të punës ose e refuzon atë, mbetet në listën e pritjes me të njëjtat pikë për një periudhë deri 2 (dy) vjet.

5. Kur dy kandidatë kanë pikë të barabarta, përzgjedhja e vendit të punës bëhet nga kandidati që i përket kategorisë së personave me aftësi të kufizuar nëse ka të tillë, nëse nuk ka PAK, vendi i punës i ofrohet kandidatit që ka pikët më të larta në testimin me shkrim.

6. Kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në institucionet në varësi të OSHKSH-së, merr aktin e emërimit nga DROSHKSH-ja dhe paraqitet pranë institucionit shëndetësor për të

lidhur kontratën e punës, kandidati fitues që përzgjedh vendin e punës në Qendrat Spitalore Universitare, pajiset nga DROSHKSH-ja me vërtetimin për përzgjedhjen e bërë, si dhe fletë të printuar nga portali për rezultatin e tij. Titullari i institucionit lidh kontratë pune pa afat me punonjësin që zë një vend të lirë pune. Periudha e provës është tre muaj.

7. DROSHKSH-ja dokumenton procesin e zgjedhjes së vendeve të punës për çdo kandidat, si dhe raporton me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare në DQOSHKSH, si dhe në MSHMS, brenda datës tre të çdo muaji për emërimet/refuzimet apo moskonfirmimet e kandidatëve.

8. Në rastin e krijimit të vendeve vakant të përkohshme (leje barrëlindje, pezullime etj.), pozicionet plotësohen nga kandidatët fitues në listë pritje, të cilët njoftohen sipas renditjes me pikë:

a) kandidati që punon si zëvendësues njoftohet sa herë krijohen vende të lira pune në NJVKSH përkatëse sipas radhës së listës së pritjes, për të zgjedhur vendet vakant të krijuara;

b) në rast se gjatë periudhës së punës si zëvendësues, në institucionin ku punon krijohet një vend i lirë pune, zëvendësuesi kalon me emërim definitiv, pavarësisht renditjes së tij me pikë;

c) në rast se në një institucion ka më shumë se një punonjës zëvendësues fitues i portalit, vendi definitiv i ofrohet atij që ka pikë më shumë.

d) në rast se deri në përfundim të periudhës së punës si zëvendësues nuk kalon në pozicion pune definitiv, kandidati kalon në listën e pritjes i renditur sipas pikëve të tij.

9. Në rast se do të ketë vende të lira pune, të cilat do të refuzohen nga të gjithë kandidatët fitues, këto pozicione mund të plotësohen nga kandidatë të licencuar në profilin përkatës, me emërim të përkohshëm deri në ardhjen e një kandidati fitues. Në këto raste NJVKSH i drejtohet me kërkesë DROSHKSH-së për miratimin e emërimit të përkohshëm.

KREU 5
PROCEDURA E LËVIZJES PARALELE

1. Procedura e lëvizjes paralele bëhet për plotësimin e vendeve të lira vetëm brenda NJVKSH-së përkatëse.

2. Punonjësit e emëruar nëpërmjet portalit "Infermier për Shqipërinë" u lind e drejta për të kërkuar lëvizje paralele pasi të kenë mbushur 2 (dy) vite në të njëjtin vend pune.

3. Punonjësi i shkencave mjekësore teknike bën kërkesë për lëvizje paralele nga një qendër shëndetësore në një tjetër qendër shëndetësore ose spital dhe anasjelltas. NJVKSH-ja merr masa për mbulimin e shërbimit në qendrën nga e cila kërkon të largohet punonjësi dhe e dërgon kërkesën për miratimin e lëvizjes pranë DROSHKSH-së.

4. Lëvizjet paralele raportohen nga DROSHKSH-ja, brenda datës pesë të çdo muaji, pranë DQOSHKSH-së dhe Ministrisë.

KREU 6
MASA DISIPLINORE DHE LARGIMI NGA PUNA I TEKNIKËVE TË SHKENCAVE MJEKËSORE

1. Procedura disiplinore ndaj teknikut të shkencave mjekësore fillon nga drejtori/titullari i institucionit ku është i punësuar punonjësi.

2. Shkeljet disiplinore, si rregull përcaktohen në kontratën individuale të punës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Procedura disiplinore duhet të garantojë të drejtën e punonjësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, si dhe të drejtën për tu ankuar ndaj vendimit përfundimtar.

4. Tekniku i shkencave mjekësore mund të pezullohet nga puna për shkaqe të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjatë kohës së pezullimit, punonjësit i ndërpriten marrëdhëniet financiare.

5. Largimi nga puna i teknikut të shkencave mjekësore bëhet nga drejtori/titullari i institucionit sipas akteve ligjore në fuqi dhe njoftohet NJVKSH/DROSHKSH përkatës.

KREU 7
DISPOZITA KALIMTARE
DHE TË FUNDIT

1. Për vitin 2019, të gjithë studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 në profilet e shkencave mjekësore teknike, që aplikojnë në portalin "Infermier për Shqipërinë", marrin një bonus 10 pikë shtesë në llogaritjen e pikëve për vlerësimin e dosjes. "Studentë të ekselencës", janë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të arsimit të lartë me mesatare 9.00–10 ose ekuivalent.

2. Të gjithë kandidatët që kanë marrë më parë pjesë në testimin "Infermierë për Shqipërinë" dhe nuk janë punësuar, do të dorëzojnë kërkesën për t'u regjistruar në listën e pritjes, pranë DROSHKSH-së përkatëse, duke përcaktuar deri në tre NJVKSH. Kandidatët që kanë aplikuar në më shumë se një qark do të përzgjedhin për t'u regjistruar në listën e pritjes, jo më shumë se tre NJVKSH gjithsej.

Kandidatët duhet të paraqesin kërkesën e tyre pranë DROSHKSH brenda një muaji nga miratimi i këtij udhëzimi. Deri në kryerjen e regjistrimit të kandidatëve si më sipër, do të veprohet sipas listave në rang qarku.

3. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet pranë DROSHKSH për 10 (vite) vite dhe janë objekt i inspektimit të institucioneve të autorizuara nga ligji.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, si dhe institucionet shëndetësore.

5. Urdhri nr. 492, datë 13.11.2017 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e testimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike për vendet vakante në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë", si dhe udhëzimin nr. 493, datë 13.11.2017 "Për procedurat e rekrutimit për profesionet e shkencave mjekësore në institucionet shëndetësore publike në RSH", të ndryshuar, shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

SHTOJCA 1

CURRICULUM VITAE

Emri, Mbiemri
Datëlindja: dd/mm/vvvv
Telefoni:
Adresa:
E-mail:
Arsimi:
Leja e ushtrimit të profesionit _____, (nr... data e lëshimit):
Kualifikim shkencor
Punësimi: Vitet dhe institucioni
Publikimet në fushën e shëndetësisë dhe fakti nëse është autor i parë ose bashkautor
Gjuhë të huaja: Niveli/ nota dhe institucioni që e ka lëshuar

SHTOJCA 2
DEKLARATË
PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për profilin ----------, të zhvilluar në _____ , më datë ----------, autorizoj _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

AUTORIZUESI
_____

SHTOJCA 3
KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR USHTRIMIN E PROFESIONEVE TË SHKENCAVE TEKNIKE MJEKËSORE

Nr.	Treguesit dhe kriteret	Pikët
1.	Përvoja në punë si profesionist i shkencave mjekësore teknike (një pikë për çdo vit pune, deri në 10 vite eksperiencë pune)	1-10 pikë
2.	Studentët ekselent në fund të vlerësimit të dosjes dhjetë pikë shtesë (deri në 30 pikë gjithsej për vlerësimin e dosjes)	10 pikë
3.	Nota mesatare e studimeve të larta, vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme: Nota mesatare (e thjeshtë) 5.00 - 5.50 = 1 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 5.51 - 6.00 = 2 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.01 - 6.50 = 3 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 6.51 - 7.00 = 4 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.01 - 7.50 = 5 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 7.51 - 8.00 = 6 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.01 - 8.50 = 7 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 8.51 - 9.00 = 8 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.01 - 9.50 = 9 pikë Nota mesatare (e thjeshtë) 9.51 - 10.00 = 10 pikë	1 -10 pikë
4.	Shkallët e kualifikimit në fushën e shëndetësisë: Studime të nivelit Mastër Profesional - 3 pikë Studime të nivelit Mastër Shkencor (të barasvlershëm) - 5 pikë	0- 5 pikë
5.	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja: a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL - të publike = 2 pikë b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B 1 = 2 pikë c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B 2 = 4 pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund të llogariten më shumë se 5 pikë në vlerësimin e dosjes. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do të llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	0 - 5 pikë

SHTOJCA 4
DEKLARATË PËR PAJTUESHMËRINË ME LIGJIN PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Deklaroj në përgjegjësinë time se në procesin e konkurimit për pozicionin infermier/teknik imazherie/ teknik fizioterapie_____ që do të zhvillohet në datë _____, nuk jam në konflikt interesi me asnjë prej kandidaturave të paraqitura për konkurrim.

DEKLARUESI
DATA

URDHËR
Nr. 23, datë 1.7.2019

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE, GJATË PROCESIT *ONLINE* TË INSPEKTIMIT" PËR INSPEKTORATET SHTETËRORE DHE VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 9 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013 "Për përcaktimin e procedurave dhe kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-Inspektimi"

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale., gjatë procesit *online* të inspektimit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen inspektoratet shtetërore dhe vendore për zbatimin e këtij urdhri.
3. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe iu njoftohet inspektorateve shtetërore dhe vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari

RREGULLORE
PËR MBROJTJEN, PËRPUNIMIN, RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE, GJATË PROCESIT *ONLINE* TË INSPEKTIMIT PËR INSPEKTORATET SHTETËRORE DHE VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

KREU I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 1 Objekti
Neni 2 Baza Ligjore
Neni 3 Qëllimi
Neni 4 Përkufizime
Neni 5 Fusha e zbatimit
Neni 6 Parimet e sigurisë së informacionit të inspektimit
KREU II. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE
Neni 7 Mbrojtja e të dhënave personale
Neni 8 Qëllimi i përpunimit
Neni 9 Kriteret e përpunimit të të dhënave personale
Neni 10 Rastet e dorëzimit të të dhënave
Neni 11 Përdoruesit e të dhënave të administruara në portalin unik "e-Inspektimi"
KREU III. TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE
Neni 12 Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale
Neni 13 Kërkesa për informacion
KREU IV. NËNSHKRIMI ELEKTRONIK
Neni 14 Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike
Neni 15 Detyrimi për informim mbi vlefshmërinë ligjore
KREU V. SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE
Neni 16 Masat për sigurinë e të dhënave
Neni 17 Mbrojtja e pajisjeve elektronike
Neni 18 Përpunimi i të dhënave të administruara në portalin unik "e-Inspektimi"
KREU VI. SANKSIONE ADMINI-STRATIVE
Neni 19 Masat administrative
Neni 20 Mbikëqyrja e masave dhe procedurave mbrojtëse
KREU VII. DISPOZITA TË FUNDIT
Neni 21 Konfidencialiteti dhe besueshmëria

Neni 22 Detyrimi për bashkëpunim
Neni 23 Detyrimi për zbatim
Neni 24 Sanksionet
Neni 25 Hyrja në fuqi

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj Rregullore, është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, sigurinë dhe ruajtjen e të dhënave personale të administruara, gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, nga inspektorët e inspektorateve shtetërore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Baza Ligjore

1. Kjo Rregullore mbështetet në një legjislacion të gjerë, vendas dhe ndërkombëtar, për mbrojtjen e të dhënave personale, në të cilin bazohet kryerja e procesit *online* të inspektimit.

2. Aktet kombëtare janë:

a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

b) Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;

c) ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar;

d) ligji nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";

e) ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";

f) ligji nr. 9880, datë 25.2.2008, "Për nënshkrimin elektronik";

g) vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-Inspektimi";

h) urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 15, datë 7.5.2015, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit "e-inspektimi";

i) urdhri i Inspektorit të Përgjithshëm nr. 25, datë 10.8.2018, "Për miratimin e Rregullores "Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve si një proces i rregullt administrativ";

j) urdhrat, udhëzimet dhe vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

3. Aktet ndërkombëtare janë:

a) Deklarata Universale e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut;

b) Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, amenduar nga Protokolli nr. 11, hyrë në fuqi më 1 Nëntor 1998;

c) direktivat 2002/58/EC dhe 95/46/EC të Këshillit Evropian dhe Parlamentit Evropian;

d) Konventa 108 e Këshillit të Evropës, "Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale", ratifikuar me ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004;

e) Protokolli shtesë i Konventës së Këshillit të Evropës, "Për mbrojtjen e individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, lidhur me autoritetet mbikëqyrëse dhe lëvizjen ndërkufitare të të dhënave personale", ratifikuar me ligjin nr. 9287, datë 7.10.2004.

Neni 3
Qëllimi

Kjo Rregullore, ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme dhe masat për mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, të administruara gjatë kryerjes së procedurës së inspektimit, në portalin unik të inspektimeve "e-inspektimi". Ajo zbatohet për të gjitha të dhënat e administruara, gjatë veprimtarisë së inspektimit dhe/ose përpunuara nga përdoruesit e inspektorateve shtetërore dhe vendore, në përputhje me ligjin nr. 9887/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përpunimi i të dhënave duhet të bëhet në përputhje me Kushtetutën, ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar, si dhe me qëllimin dhe parimet e inspektimit, duke mbrojtur interesin publik dhe interesat e ligjshme të personave fizikë dhe juridikë.

Ky akt nënligjor, përcakton kriteret e sigurisë për përdoruesit e autorizuar, me të drejtë aksesi në portalin unik "e-Inspektimi".

Neni 4
Përkufizime

1. Në funksion të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Të dhëna personale": është çdo informacion, që administrohet pranë inspektorateve shtetërore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me një person fizik, direkt ose indirekt, në veçanti duke ju referuar një numri identifikimi, ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij;

b) "E dhënë anonime": është çdo e dhënë, e administruar pranë inspektorateve shtetërore dhe vendore, që në origjinë ose gjatë përpunimit, nuk mund t'i shoqërohet një individi, të identifikuar ose të identifikueshëm;

c) "Përpunim i të dhënave personale": është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash;

d) "Subjekt i të dhënave": është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale;

e) "Kontrollues": Për efekt të kësaj Rregullore është Inspektorati Qendror, i cili vetëm apo së bashku me të tjerë, në përmbushje të detyrimeve ligjore, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligj;

f) "Përpunues": Për efekt të kësaj Rregullore janë punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore, përveç punonjësve të kontrolluesit, që përpunojnë të dhëna personale, të administruara nëpërmjet procedurës inspektuese;

g) "Marrës": është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër, të cilit i janë dhënë të dhënat e një pale të tretë ose jo.

h) "E drejtë informimi" dhe "Programe të transparencës": kanë kuptimet sipas përcaktimeve në ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit";

k) "e-Inspektimi": ka kuptimin sipas përcaktimit në urdhrin nr. 15, datë 7.5.2015, "Për miratimin e rregullave për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit "e-inspektimi";

i) "Nënshkrim elektronik": është një mjet verifikimi elektronik, i cili zakonisht përcaktohet si verifikim i identitetit të zotëruesit. Çdo lloj verifikimi elektronik do të konsiderohet si nënshkrim elektronik, për sa kohë ai është i lidhur me të dhëna të tjera në formë elektronike.

2. Termat e tjerë të përdorur në zbatim të kësaj Rregullore, do të kenë të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Neni 5
Fusha e zbatimit

Kjo Rregullore zbatohet për përpunimin e të dhënave personale, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike dhe elektronike, që janë në funksion të procedurës inspektuese dhe që administrohen në portalin unik "e-Inspektimi".

Neni 6
Parimet e sigurisë së informacionit të inspektimit

Inspektorët e inspektorateve shtetërore dhe vendore, në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor për kryerjen e procedurës inspektuese, si një proces i rregullt administrativ, duhet të respektojnë parimet mbi sigurinë e informacionit të administruar, nëpërmjet procesit të inspektimit, si më poshtë:

- Parimi i integritetit, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre;
- Parimi i konfidencialitetit, duke siguruar që të dhënat e administruara nëpërmjet procedurës inspektuese të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar;
- Parimi i besueshmërisë, duke garantuar që çdo veprim i tyre mbi të dhënat, është i kontrollueshëm.

KREU II
PËRPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 7
Mbrojtja e të dhënave personale

Çdo punonjës i inspektorateve shtetërore dhe vendore, që merret me përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, të të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale, me të cilat njihet gjatë procedurës inspektuese, ka detyrimin të zbatojë kërkesat e neneve 2 dhe 5, të Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2018, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, si më poshtë:

1. Respektimin e parimit për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private;

2. Kryerjen e përpunimit të të dhënave personale në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;

3. Grumbullimin e të dhënave personale për qëllime specifike, legjitime e të përcaktuara qartë, si dhe kryerjen e përpunimit të tyre në përputhje me këto qëllime;

4. Mbajtja e dokumentacionit të inspektimit nga personi/personat e autorizuar për çështjet inspektuese.

5. Të dhënat që do të përpunohen duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin legjitim të përpunimit dhe të inspektimit, si dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;

6. Të dhënat duhet të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin dhe për aq sa është e nevojshme për procesin *online* të inspektimit dhe jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë administruar.

7. Marrja e masave për të shmangur rastet e incidenteve, që mund të shkaktojnë shkeljen e sigurisë së të dhënave, të administruara në pajisjet *tablet* për inspektimin, dhe në portalin elektronik "e-Inspektimi".

Neni 8
Qëllimi i përpunimit

Çdo inspektor i inspektorateve shtetërore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë, i cili në funksion të përmbushjes së detyrimeve, që rrjedhin nga ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjet organike dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tyre, si dhe vihet në dijeni me të dhëna personale, të dhëna që lidhen me veprimtarinë tregtare ose profesionale të subjekteve, ka detyrimin e përpunimit të drejtë e të ligjshëm të tyre, si dhe të ndërmarrë masa lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e tyre, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Neni 9
Kriteret e përpunimit të të dhënave personale

1. Inspektorët e inspektorateve shtetërore dhe vendore, që përpunojnë të dhëna personale të subjekteve, të administruara gjatë veprimtarisë inspektuese, në portalin unik "e-inspektimi", bazohen në kriteret e përcaktuara në nenin 6, të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Të dhënat personale përpunohen nga ana e inspektorit, vetëm me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për kryerjen e inspektimeve *online*, si një proces i rregullt administrativ, i cili brenda kuadrit ligjor, duhet të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duhet të kontribuojë në realizimin e tyre.

Neni 10
Rastet e dorëzimit të të dhënave

Personi i autorizuar me të drejtë aksesi në portalin unik "e-Inspektimi", lidhur me të dhënat e administruara në portal, gjatë procesit *online* të inspektimit në subjektin, objekt inspektimi, i dorëzon një Autoriteti, me kërkesë të këtij të fundit, të dhëna për aktet e mbajtura në subjekt, si dhe prova të administruara me video, audio dhe foto nga trupa inspektuese, në rastet si më poshtë:

a) kur kjo është e nevojshme, gjatë shqyrtimit të ankimimit të subjektit nga trupa kolegjiale pranë Inspektorateve Shtetërore, ose gjatë shqyrtimit të ankimimit të subjektit në gjykatë;

b) kur kjo është e nevojshme, për ndjekjen e veprave penale ose të shkeljeve ligjore dhe kur

një kërkesë e tillë vjen nga organet e ngarkuara me ligj për hetimin e tyre;

c) për të shmangur rrezikun, që i kanoset sigurisë kombëtare ose rendit publik;

d) për të kryer detyrat, që u ka ngarkuar ligji autoriteteve në hetimin e shkeljeve ligjore;

e) kur një gjë të tillë e vendos gjykata.

Neni 11
Përdoruesit e të dhënave të administruara në portalin unik "e-Inspektimi"

Përpunuesit e të dhënave të administruara në portalin unik "e-Inspektimi", gjatë veprimtarisë së inspektimit:

1. Sigurojnë se materialet e administruara gjatë veprimtarisë inspektuese në subjekt, si dhe fotot, videot dhe audiot, nuk mund të ruhen/përdoren jashtë qëllimeve të përcaktuara në ligjin për inspektimin dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij.

2. Të dhënat e administruara gjatë veprimtarisë së inspektimit në subjekt, nuk mund të aksesohen nga përdorues të paautorizuar.

3. Përjashtojnë mundësinë e ndërhyrjeve në procedurën e inspektimit me qëllim tjetërsimin e të dhënave të administruara në portal gjatë veprimtarisë inspektuese në subjektin, objekt inspektimi.

KREU III
TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 12
Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale

1. Përhapja ose komunikimi i të dhënave personale kryhet në përputhje me qëllimin për të cilin janë grumbulluar këto të dhëna.

2. Kërkuesi i informacionit, ose personi i autorizuar prej tij, ka të drejtë që të njihet me të dhënat e administruara gjatë veprimtarisë inspektuese nga trupa inspektuese, nëpërmjet një kërkese drejtuar inspektorateve shtetërore dhe/ose vendore.

3. Inspektoratet shtetërore dhe vendore kanë detyrimin që në bazë të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, të zbatojnë këto të drejta të subjekteve të të dhënave personale:

a) të drejtën për të kontestuar;

b) të drejtën për t'u ankuar.

4. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për të vërtetuar identitetin e kërkuesit. Kërkesa mund të administrohet pranë Inspektoratit Shtetëror ose Vendor, në formë postare, ose nëpërmjet faqes zyrtare. Inspektorati Shtetëror ose Vendor, brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

Neni 13
Kërkesa për informacion

Kërkesën për informacion mund ta bëjë:

1. Vetë personi;

2. Përfaqësuesi ligjor, i pajisur me autorizimin përkatës;

3. Persona të tjerë, të cilët megjithëse nuk kanë interes të drejtpërdrejtë, provojnë se kanë një interes të ligjshëm për të marrë dijeni mbi këto të dhëna dhe që përputhet me qëllimin e grumbullimit të këtyre të dhënave. Dhënia e informacionit, në këtë rast, bëhet në mënyrë të tillë dhe për aq sa nuk cenohen të drejtat e subjektit të të dhënave, në përputhje me parimet e sanksionuara në ligjin nr. 9987/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

KREU IV
NËNSHKRIMI ELEKTRONIK

Neni 14
Vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike

Dokumenti elektronik, "Procesverbal inspektimi", i cili mban emrin e nënshkruesit inspektor/ët, subjektit ose përfaqësuesit të tij dhe nënshkrimet e tyre të kualifikuara, kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore.

Neni 15
Detyrimi për informim mbi vlefshmërinë ligjore

Inspektori i Inspektoratit Shtetëror dhe/ose Vendor, si përfaqësues i nënshkrimit elektronik të dokumenteve të mbajtura në portalin unik "e-inspektimi", informon subjektin se nënshkrimi elektronik i kualifikuar në veprimet juridike dhe aktet e mbajtura, kanë të njëjtën vlefshmëri sikurse edhe nënshkrimi në formë shkresore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligjin për nënshkrimin elektronik.

KREU V
SIGURIA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 16
Masat për sigurinë e të dhënave

1. Inspektoratet shtetërore dhe vendore, në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, marrin masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në portalin unik "e-Inspektimi", si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Platforma unike "e-Inspektimi" mbështetet në infrastrukturën mbrojtëse, që ofron sistemi GovNet, i cili administrohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2017, "Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit". Kjo do të thotë që platforma "e-Inspektimi", mbështetet te mekanizmat e mbrojtjes së trafikut të rrjetit që ka GovNet, në filtrimet e kodit me qëllime keqdashëse të GovNet dhe në mekanizmat e tij për mbrojtjen nga ndërhyrjet apo sulmet e jashtme.

3. Punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore, pa përjashtim, udhëzohen për detyrimet që kanë, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar, aktet nënligjore, si dhe Rregulloren "Për mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë procesit *online* të inspektimit".

4. Ndalohet përdorimi i paautorizuar i pajisjeve *tablet*, të cilat janë vetëm në funksion të kryerjes së procesit *online* të inspektimit.

5. Punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore nuk duhet të lënë në vende të pasigurta pajisjet *tablet* apo pajisje të tjera, të cilat janë në funksion të procedurës inspektuese.

6. Të dhënat personale mbrohen, duke verifikuar identitetin e përdoruesit dhe duke i lejuar akses vetëm individëve të autorizuar.

7. Punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore, kryejnë vazhdimisht procedurën e hyrjes dhe daljes në portalin unik të inspektimeve "e-inspektimi", duke përdorur fjalëkalime personale.

8. Të dhënat e dokumentuara, nuk përdoren për qëllime të tjera, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit/inspektimit.

9. Dokumentacioni fizik dhe elektronik, ruhet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

10. Punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore, respektojnë aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që përcaktojnë se si duhet të përdoren të dhënat personale.

Neni 17
Mbrojtja e pajisjeve elektronike

Pajisjet elektronike për kryerjen e procedurës inspektuese, si dhe përpunimin e të dhënave dhe informacioneve lidhur me inspektimin, përdoren vetëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara në ligjin dhe aktet nënligjore mbi inspektimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe në këtë rregullore. Këto pajisje përdoren vetëm nga personat e autorizuar të inspektorateve shtetërore dhe vendore.

Neni 18
Përpunimi i të dhënave të administruara në portalin unik "e-inspektimi"

1. Të dhënat e administruara në portalin unik "e-inspektimi", përbëjnë të dhëna personale, kur një individ mund të identifikohet drejtpërdrejt ose tërthorazi në bazë të regjistrimeve. Në çdo rast, nëse administrohen të dhëna të tilla, ato do

të konsiderohen të ligjshme nëse janë në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në ligjin për inspektimin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe duke respektuar kriteret e përcaktuara në nenin 6, të ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Të dhënat identifikuese nëpërmjet pajisjes *tablet*, me foto, video & audio rekorder, mund të lejohen vetëm nëse qëllimi i inspektimit nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër.

3. Qëllimi i fotografimit dhe regjistrimit nëpërmjet sistemit "video & audio rekorder", duhet të jetë vetëm për realizimin e procedurës inspektuese, brenda kuadrit ligjor mbi inspektimin. Fotografimet, regjistrimet video dhe audio rekorder, mund të përdoren vetëm në funksion të kryerjes së procedurës *online* të inspektimit.

4. Masat e sigurisë duhet të jenë të tilla në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese, në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga aksesi i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

5. Ndalohet përhapja e imazheve të përfituara nëpërmjet pajisjes *tablet*, gjatë ushtrimit të procedurës *online* të inspektimit.

KREU VI
SANKSIONE ADMINISTRATIVE

Neni 19
Masat administrative

Çdo punonjës i Inspektoratit Shtetëror dhe Vendor, i cili shkel detyrimin për të mbrojtur të dhënat personale është përgjegjës për thyerje të disiplinës, rregullave, dhe detyrimeve në veprimtarinë e punës së tij. Në qoftë se veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndaj tyre merren masa administrative dhe disiplinore sipas akteve normative në fuqi.

Neni 20
Mbikëqyrja e masave dhe procedurave mbrojtëse

Mbikëqyrja e implementimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale për respektimin e normave të sigurisë, për mbrojtjen e të dhënave të automatizuara kundër prishjes së tyre aksidentale, ose të paautorizuar, si dhe kundër hyrjes, ndryshimit dhe përhapjes së paautorizuar të tyre, realizohet nga personat përgjegjës për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të dhënave respektive.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21
Konfidencialiteti dhe besueshmëria

Çdo punonjës i Inspektoratit Shtetëror dhe Vendor, që përpunon të dhëna apo vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara, nuk mund të bëjë të njohur përmbajtjen e këtyre të dhënave, personave të tjerë.

Çdo punonjës i Inspektoratit Shtetëror dhe Vendor, i cili ka akses në të dhënat personale të administruara në portalin elektronik "e-Inspektimi", ka detyrimin e mbrojtjes, ruajtjes, mospërhapjes së këtyre të dhënave, gjatë dhe pas mbarimit të detyrës.

Personat e autorizuar me të drejtë aksesi në të dhënat personale të administruara në portalin unik "e-Inspektimi" me foto, video dhe audio, duhet të ushtrojnë detyrën funksionale duke respektuar dhe garantuar parimin e besueshmërisë.

Neni 22
Detyrimi për bashkëpunim

Punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore duhet të jenë të ndërgjegjshëm për detyrimin që kanë për të bashkëpunuar me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për t'i siguruar të gjithë informacionin, që ai kërkon për përmbushjen e detyrave, që i janë ngarkuar sipas nenit 29, të ligjit nr. 9887/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Neni 23
Detyrimi për zbatim

Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të

detyrueshme për zbatim nga punonjësit e inspektorateve shtetërore dhe vendore.

Çdo punonjës që merret me përpunimin e të dhënave personale është i ndërgjegjshëm se përpunimi i të dhënave personale në kundërshtim me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative.

Neni 24
Sanksionet

Kjo Rregullore është pjesë e akteve nënligjore mbi inspektimin dhe mosrespektimi i kërkesave të saj përbën shkelje të disiplinës në punë dhe ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 102, datë 5.7.2019

MBI KRITERET E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE JOGJYQTARË DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË

Në mbështetje të nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të neneve 3, 4 dhe 49 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

I. Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i kritereve të vlerësimit, pikëzimit e të renditjes, si dhe të rregullave më të hollësishme mbi procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve jogjyqtarë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.

2. Ky vendim parashikon rregulla më të detajuara në lidhje me:

a) kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtarë për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë;

b) veprimet dhe procedurat që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të kryejë për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtarë, në funksion të përzgjedhjes dhe propozimit për t'u emëruar, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, të juristit më të spikatur.

II. Kuadri ligjor

1. Ky vendim do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:

a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

b) Kodin e Procedurave Administrative;

c) ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (Ligji për qeverisjen);

ç) ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (Ligji për statusin);

d) ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

dh) ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";

e) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;

ë) ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

f) ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësit civilë", i ndryshuar.

III. Përkufizime

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Procedurë e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim", më poshtë referuar edhe si "procedurë e përzgjedhjes së kandidatëve", është procesi administrativ i vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve i finalizuar me vendimin për propozimin për emërim të një kandidati në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.

2. "Vendim vlerësimi dhe pikëzimi" është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor i marrë në kuadër të një procedure përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim dhe që përmban vlerësimin dhe pikëzimin e të gjithë kandidatëve të kualifikuar për t'u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.

3. "Kandidatë të kualifikuar për t'u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë" janë të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses verifikimin e kushteve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës, sipas kuptimit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.5.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë".

4. "Listë e kandidatëve më të mirë" është lista me emrat e jo më shumë së 5 kandidatëve të përfshirë në një procedurë përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim, të cilët janë vlerësuar dhe renditur paraprakisht më mirë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të kësaj procedure. Këta kandidatë duhet të merren në pyetje nga Këshilli në një seancë dëgjimore.

5. "Vendim propozimi për emërim" është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor që merret në përfundim të një procedure përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim dhe që i dërgohet Presidentit të Republikës. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kritereve ligjore të të gjithë kandidatëve për një pozicion të lirë, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e kandidatëve, duke filluar nga kandidati që është vlerësuar më mirë.

6. "Këshill" është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

7. "Komision" është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përbërje të të cilit janë 3 anëtarët e përhershëm dhe/ose 2 anëtarët zëvendësues. Në rastet kur, për arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, Këshilli vendos që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit për një procedurë përzgjedhje të kandidatëve për emërim, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues, Komisioni në çdo rast përbëhet patjetër nga Kryetari dhe një anëtar i përhershëm, nga radhët e gjyqtarëve ose jogjyqtarëve, në varësi të radhëve nga vjen anëtari zëvendësues i caktuar si relator.

8. "Relator" është anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, anëtari i përhershëm ose anëtari zëvendësues, i zgjedhur me short, për të kryer një procedurë përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim.

9. "Ekspert" është specialisti i një fushe të caktuar, që përzgjidhet nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione apo subjekte të tjera të specializuara.

IV. Kriteret për vlerësimin e kandidatëve, pesha e tyre specifike dhe pikëzimi

1. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për çdo pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, ka për qëllim identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Identifikimi i kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur, bazohet në këto kategori kriteresh:

a) meritat profesionale;

b) meritat morale dhe etike;

c) meritat organizative dhe menaxheriale.

3. Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve Këshilli mbështetet në këta tregues:

a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë, duke patur parasysh për këtë nenin 31 të ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";

b) vlerësimi i punës së kandidatit, përmes të paktën 5 (pesë) dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion në 5 (pesë) vitet e fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit sipas rëndësisë së punimit, nëpërmjet të cilave tregohen të dhëna edhe për pjesëmarrjen e kandidatit në aktivitetet shkencore, në procese të hartimit ose të konsultimit të legjislacionit, apo në çdo angazhim tjetër profesional;

c) rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion, ose çdo trajnimi tjetër;

ç) cilësitë morale të kandidatit, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi.

d) cilësinë e platformës dhe të vizionit të kandidatit, për aftësitë e tij për të marrë vendime

dhe përgjegjësi referuar përvojave të mëparshme profesionale, për aftësitë e komunikimit, për aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;

dh) aftësitë gjuhësore të kandidatit, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.

4. Detajimi i mëtejshëm i kategorive të kritereve të vlerësimit dhe i treguesve për secilën nga ato, përcaktimi i peshës specifike të tyre në pikëzimin e kandidatëve, përcaktohet në shtojcën "Kriteret e vlerësimit dhe të dhënat për metodologjinë e pikëzimit të kandidatëve jogjyqtarë për në gjykatën e Lartë", bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Për efekt të renditjes së kandidatëve, pikëzimi përfundimtar i kandidatit të vlerësuar është shuma e pikëve që rezulton nga vlerësimi i secilit prej kritereve të vlerësimit.

6. Ndarja e kritereve, lista e treguesve që mund të merren parasysh në secilën kategori, pikëzimi maksimal i secilës prej tyre, burimet dokumentare dhe metoda e vlerësimit përcaktohen në mënyrë të hollësishme nga shtojca "Kriteret e vlerësimit dhe të dhënat për metodologjinë e pikëzimit të kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë" e këtij vendimi.

7. Këshilli, me akt të veçantë, miraton metodologjinë mbi të cilën bazohet për vlerësimin dhe caktimin e pikëve lidhur me secilin prej kritereve dhe treguesve të treguar në shtojcën e këtij vendimi.

V. Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

1. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, fillon me vendim të Këshillit, jo me vone së 7 ditë, nga vendimi i parë përfundimtar i Këshillit për kualifikimin për emërim të një kandidati për atë pozicion të lirë.

2. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë vazhdon krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që kandidojnë për atë pozicion të lirë. Vetëm kandidatët e kualifikuar për t'u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.

3. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë, Këshilli zhvillon edhe procedurën e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit të asaj procedure të përzgjedhjes së kandidatëve. Përmes shortit realizohet shpërndarja rastësore dhe e barabartë, në vijimësi, e ngarkesës së punës sa i përket procedurave të ndryshme të përzgjedhjes së kandidatëve, midis anëtarëve të Komisionit. Këshilli, për arsye të motivuara, mbi kërkesë të çdo anëtari të Komisionit, mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.

4. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit në një ose disa procedura të përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.

5. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75 të ligjit për qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për atë pozicion të lirë, në mbledhjet e Komisionit ose në mbledhjen plenare të Këshillit.

6. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, që më herët ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar në një procedurë verifikimi të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për një nga kandidatët që kandidojnë për atë pozicion të lirë për të cilin zhvillohet procedura e përzgjedhjes së kandidatëve, nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë në rast se konflikti i interesit ose pengesa ligjore për shkak të të cilit ai ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar, vijon të ekzistojë.

7. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga zëvendëskryetari i tij.

8. Relatori i çështjes kujdeset për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim dhe sidomos për sa më poshtë:

a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati;

b) publikimin në faqen zyrtare në internet të Këshillit të listës së dokumenteve të paraqitura nga kandidatët për efekt vlerësimi profesional apo të adresës ku ato gjenden të botuara në internet, duke respektuar të drejtat e autorit;

c) përgatitjen e projektakteve administrative;

ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;

d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;

dh) njoftimet për kandidatin.

9. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në një pozicion të lirë realizohet në pesë faza:

a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes;

b) shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;

c) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si të listës së kandidatëve më të mirë;

ç) intervistimi nga Këshilli i kandidatëve më të mirë të listuar;

d) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të projektvendimit të propozimit për emërim.

B. Të drejtat e kandidatit

1. Kandidatët për një pozicion të lirë njoftohen për relatorin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve menjëherë me fillimin e kësaj procedure, përmes publikimit në faqen zyrtare në internet të Këshillit të vendimit për caktimin e relatorit.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit të çështjes për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të ligjit për qeverisjen, jo më vonë së 3 ditë, nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.

3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo me vone së 7 ditë nga paraqitja e saj.

4. Kandidati ka të drejtë të përzgjedhë dhe të paraqesë pranë Këshillit dokumente që i çmon të nevojshme për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës sipas rregullave dhe kritereve të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim.

5. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim.

6. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret e vlerësimit, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

7. Çdo kandidat i listuar më mirë, mbi kërkesën e Këshillit, ka të drejtë të dëgjohet në seancë dëgjimore, mbi motivet dhe objektivat e kandidimit, për aftësitë e tij profesionale sa i përket: ekspertizës së veçantë në fusha të veçanta të ligjit, në raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lirë; manifestimit të aftësive profesionale në dokumentet ligjore ose publikimet shkencore dhe artikujt akademik në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga ai; rezultateve të studimeve të larta për drejtësi, të Programit të Formimit Fillestar, të përvojës në profesion apo çdo trajnim tjetër; si dhe manifestimit të aftësive gjuhësore.

8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa Këshilli nuk ka përfunduar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, duke njoftuar për këtë, me shkrim, Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së

përzgjedhjes së kandidatëve për emërim të këtij kandidati dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim caktohen në ditë kalendarike.

2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

4. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24.00 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Ç. Njoftimet

1. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim bëhen me shkresë, në adresën elektronike të deklaruar nga ai për këtë qëllim, pranë Këshillit. Mbetet në detyrimin e kandidatit njoftimi menjëherë me shkrim i Këshillit për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës elektronike të deklaruar nga ai.

2. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë Këshillit ose në adresën e tij elektronike, adresë e cila iu është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, që në rastin e fillimit të procedurave të verifikimit të kandidaturave, apo përmes publikimit të saj në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Në rastet kur, për pamundësi objektive ose motive të tjera të justifikuara, kandidati nuk mund të paraqitet apo të paraqesë shpjegime dhe dokumente brenda afatit të përcaktuar në këtë vendim, ai njofton menjëherë relatorin ose Këshillin. Kur i vlerëson motivet e parashtruara me shkrim si të justifikuara, relatori apo Këshilli i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm.

VI. Fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes

1. Veprimet përgatitore për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë zhvillohen krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për të gjithë kandidatët për atë pozicion të lirë. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë përfshihen vetëm kandidatët e kualifikuar për t'u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit.

2. Relatori i çështjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale në lidhje me:

a) komunikimin me kandidatët sa i përket paraqitjes, pranimit dhe plotësimit të dokumenteve të nevojshme për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e tyre sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij vendimi;

b) përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e projektvendimeve të nevojshme për shqyrtim nga Komisioni dhe Këshilli lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve.

3. Relatori i çështjes, krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, realizon procedurat standarde si më poshtë:

a) administron kopje të plotë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve;

b) njofton kandidatin për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar dokumentet e paraqitura, në rastet kur vlerëson së janë me mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit;

c) përgatit dhe paraqit për shqyrtim relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve dhe përmbledhjen faktike të tyre për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;

ç) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.

d) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;

dh) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin përfundimtar të renditjes së kandidateve;

e) paraqet, në Komision, listën e ekspertëve që mund të jetë e nevojshme të thirren në procedurën e përzgjedhjes.

4. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori i çështjes ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit të çështjes.

5. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njësisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit.

6. Brenda 7 ditëve nga ajo e njoftimit publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit në lidhje me caktimin e relatorit për procedurën përkatëse të përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë, kandidati i parë i kualifikuar nga Këshilli për t'u emëruar, ka detyrimin të dorëzojë pranë Këshillit dokumentet e nevojshme për përzgjedhjen, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve sipas përcaktimeve të ligjit dhe të këtij vendimi. Për kandidatët e tjerë, të kualifikuar më pas për t'u emëruar, ky afat fillon nga dita e njoftimit atyre të vendimit përkatës të kualifikimit të Këshillit.

7. Lista e dokumenteve që kandidati dorëzon në kopje origjinale ose të vërtetuar sipas ligjit përfshin:

a) jetëshkrimin e përditësuar me të dhënat deri në kohën e dorëzimit sipas pikës 6 të këtij seksioni, të hartuar sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli;

b) dokumentin që përshkruan motivimin e kandidimit dhe objektivat nëse emërohet;

c) pesë dokumente profesionale të përzgjedhura nga vetë kandidati për vlerësim sipas metodologjisë së vlerësimit dhe pikëzimit të miratuar nga Këshilli;

ç) dokumente të tjerë që shërbejnë për vlerësimin e kandidatit, sipas përcaktimeve orientuese në shtojcën e këtij vendimi, në zërin "Burimet e vlerësimit", për secilën kategori dhe kriter vlerësimi ose/dhe në metodologjinë e vlerësimit dhe pikëzimit të miratuar nga Këshilli;

d) deklarimin, nëse zotëron, të njohurive në gjuhë të huaja, të shoqëruar, nëse i disponon, me dokumente përkatëse vërtetuese të lëshuar nga subjekte publike ose private të specializuara.

8. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, relatori i çështjes vlerëson së ka mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë së 5 ditë për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar mangësitë e dokumentit të paraqitur.

9. Mungesa e përgjigjes së kandidatit për dhënien e shpjegimeve dhe për saktësimin ose plotësimin e mangësive për dokumentet e paraqitura, nuk pengon vijimin e veprimeve përgatitore të relatorit të çështjes për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit.

10. Njëkohësisht, ose menjëherë pas përgjigjes së dhënë nga kandidati sipas pikës 8 si më lart, si edhe kur vjen në dijeni për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në dokumente të paraqitura nga kandidati, relatori i çështjes mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, shpjegime, të dhëna apo kopje të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.

11. Kur vlerëson të nevojshme marrjen e mendimit të një eksperti, mbi propozim të relatorit, Komisioni mund të vendosë thirrjen e tij. Në këtë rast, relatori njofton ekspertin për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën e shërbimit të kërkuar.

12. Në ditën dhe kohën e paracaktuar, relatori verifikon paraqitjen e ekspertit, i kujton atij rëndësinë e detyrës për të cilën është thirrur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë me profesionalizëm dhe me nder detyrën që i është besuar.

13. Pas betimit, ekspertit i behet e ditur objekti i ekspertimit, emrin e kandidatit dhe objektin e ekspertimit, duke i kërkuar ekspertit të shprehet nëse është në kushte papajtueshmërie

apo konflikti interesi me të. Në këtë rast, relatori njofton kandidatin për ekspertin e thirrur, duke marrë nga ai një konfirmim për ekzistencën ose jo të ndonjë situate papajtueshmërie a konflikti interesi me ekspertin e thirrur.

14. Pas marrjes se konfirmimit nga kandidati, eksperti ftohet të njihet me materialet objekt ekspertimi dhe, kur është rasti, mund të bisedojë me kandidatin.

15. Brenda afatit që i caktohet nga relatori, eksperti harton mendimin me shkrim në lidhje me çështjet e shtruara për ekspertim.

16. Pas kryerjes së veprimeve përgatitore të parashikuara në pikat 6 deri 15 të këtij seksioni dhe duke u bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në ligj, të detajuara në këtë vendim dhe në shtojcën e tij, relatori i çështjes:

a) shqyrton dhe përgatit dokumentacionin e secilit kandidat për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës;

b) përgatit relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve të paraqitura nga kandidati apo të ardhura nga subjekte publike a private mbi kërkesën e relatorit, përmbledhjen faktike të përmbajtjes së këtyre dokumenteve për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;

c) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.

17. Në përfundim të verifikimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për emërim në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.

B. Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.

2. Në mbledhjen e Komisionit, Kryetari fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.

3. Komisioni, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill nëse procedura e përzgjedhjes së kandidatëve është e plotë ose i kërkon relatorit të çështjes vijimin e kësaj procedure, duke evidentuar dhe veprimet procedurale dhe/ose çështjet që kanë nevoje të verifikohen më tej.

4. Relatori i çështjes ka detyrimin të kryejë veprimet dhe/ose verifikimet e evidentuara nga Komisioni, në përfundim të të cilave njofton Kryetarin e Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, duke vijuar procesi më pas sipas pikave 1 deri 3 të këtij seksioni.

C. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të listës me kandidatët më të mirë

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga Kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, i njoftohet kandidatëve. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

3. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.

4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të çështjes, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:

a) plotësinë e veprimeve procedurale të kryera gjatë fazës së veprimeve përgatitore dhe plotësinë

e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim nga ana e të gjithë kandidatëve;

b) miratimin e projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;

c) miratimin e listës me kandidatët më të mirë;

ç) përcaktimin e kalendarit të intervistave me kandidatët e listuar më mirë;

d) thirrjen, kur është rasti, të ekspertit të caktuar nga Komisioni, për të dhënë sqarime rreth ekspertimit të përgatitur nga ai vetëm sa i përket kandidatëve të listuar më mirë;

dh) caktimin e ekspertit kur vlerëson të nevojshme.

6. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli kalon në votim për secilën nga çështjet e renditura në pikën 5 të këtij seksioni, ku i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, më tej anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund Kryetari i Këshillit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

7. Nëse gjatë bisedimeve Këshilli vlerëson dhe vendos që veprimet procedurale të kryera gjatë fazës së veprimeve përgatitore dhe/ose dokumentacioni i paraqitur për vlerësim nga kandidatët nuk është i plotë, atëherë nuk vijon me bisedimin e çështjeve të tjera të renditura në pikën 5 të këtij seksioni, por shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin e çështjes të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, duke i caktuar një afat. Në seancën e radhës, që caktohet jo më vonë së 7 ditë nga njoftimi i relatorit të çështjes, ky i fundit i paraqet para Këshillit aktet shtesë. Në këtë rast, Këshilli vijon bisedimet dhe vendos për çështjet e renditura në pikën 5 të këtij seksioni.

Ç. Intervistimi nga Këshilli i kandidatëve të listuar më mirë

1. Kandidatët e listuar më mirë njoftohen për vendin, ditën dhe kohën e paraqitjes për intervistë, në një seancë dëgjimore, në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës.

2. Në seancën dëgjimore Këshilli pyet kandidatët e listuar më mirë, me qëllim për të marrë informacion mbi: motivet dhe objektivat e kandidimit; aftësitë e tyre profesionale sa i përket ekspertizës së veçantë në fusha të veçanta të ligjit në raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lirë; aftësitë profesionale të reflektuara në dokumentet ligjore dhe/ose publikimet shkencore dhe artikujt akademike në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga ata; rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, të përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër; si dhe aftësitë gjuhësore.

3. Këshilli, kur ka vendosur thirrjen e ekspertit, e njofton atë për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar. Njoftimi përmban edhe udhëzimet e Këshillit lidhur me natyrën e shërbimit të kërkuar.

4. Në ditën dhe kohën e paracaktuar, pas deklarimit të hapjes së seancës, Këshilli verifikon paraqitjen e ekspertit, i kujton atij rëndësinë e detyrës për të cilën është thirrur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë me profesionalizëm dhe me nder detyrën që i është besuar ose faktin se është nën betimin për këtë.

5. Këshilli thërret për intervistë secilin nga kandidatët e listuar më mirë.

6. Pas orientimit për mënyrën e zhvillimit të intervistës dhe kohëzgjatjen e saj, kandidati i thirrur për intervistë ftohet për parashtrimin e lirë të motiveve dhe arsyeve të kandidimit dhe objektivave që synon të ndjekë nëse emërohet në pozicionin e lirë të përkohshëm.

7. Intervista vijon me pyetje të anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet e kandidatit.

8. Eksperti i caktuar rishtazi nga Këshilli njihet me materialet objekt ekspertimi dhe, kur është rasti, mund të bisedojë me kandidatin e thirrur për intervistë. Brenda afatit që i caktohet nga Këshilli, eksperti harton mendimin me shkrim në lidhje me çështjet e shtruara për ekspertim.

9. Eksperti i thirrur më parë pyetet nga anëtarët e Këshilli për çdo çështje apo paqartësi që ata kanë në lidhje me ekspertimin e kryer sa i përket kandidatëve të listuar më mirë.

D. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të projekt-aktit të propozimit për emërim

1. Pas seancës dëgjimore me kandidatët e listuar më mirë dhe kur është rasti pas marrjes së mendimit të ekspertit të caktuar rishtazi, Këshilli vijon shqyrtimin dhe vendosë në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat.

2. Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj dhe në rregullat e detajuara të këtij vendimi e të shtojcës bashkëlidhur. Ky vlerësim mbështetet në dokumentacionin e paraqitur dhe, kur është rasti, edhe në intervistat e realizuara me kandidatët.

3. Çdo anëtar i Këshillit vlerëson meritat dhe bën pikëzimin me shkrim, në formë tabelore, për secilin kandidat. Relatori diskuton e parashtron i pari arsyetimin mbi vlerësimin e meritave të kandidatit dhe depoziton pikëzimin me shkrim për secilin kriter, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, më tej nga anëtarët e tjerë të Këshillit dhe, në fund, Kryetari i Këshillit.

4. Këshilli vijon shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, bazuar në projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, përgatitur nga relatori i çështjes dhe të miratuar paraprakisht nga Komisioni. Në projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, përveç pikëve për secilin kriter dhe totalit të pikëve, pasqyrohet edhe arsyetimi për vlerësimin e kandidatit nga Këshilli në lidhje me secilin prej kritereve.

5. Rezultati i pikëzimit për secilin prej kritereve, për çdo kandidat, rezulton nga pjesëtimi i shumës së pikëve totale të caktuara nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes me numrin e këtyre të fundit.

6. Këshilli, pasi verifikon saktësinë e projektvendimit të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, e miraton atë.

7. Pas vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat, Këshilli vijon shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me renditjen e kandidatëve, bazuar projektvendimin e renditjes së kandidatëve, përgatitur nga relatori i çështjes dhe i miratuar paraprakisht nga Komisioni.

8. Renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në rezultatin e pikëzimit për secilin nga ata.

9. Në rast të rezultateve të njëjta të pikëve mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga vitet e eksperiencës profesionale të përshtatshme për pozicionin e lirë. Në rast se edhe pas kësaj ka barazi mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga njohuritë e gjuhës së një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.

10. Këshilli, pasi verifikon saktësinë e projektvendimit të renditjes së kandidatëve, e miraton atë.

11. Pas vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, në mbledhjen e radhës, Këshilli vijon shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me projektvendimin e propozimit për emërim, përgatitur nga relatori i çështjes dhe i miratuar paraprakisht nga Komisioni. Projektvendimi i propozimit për emërim duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kritereve ligjore prej kandidatëve, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e tyre përfundimtare.

12. Këshilli, pasi verifikon saktësinë dhe plotësinë e arsyetimit të projektvendimit të propozimit për emërim, e miraton atë. Relatori i çështjes, jo më vonë së 10 ditë nga miratimi, harton vendimin e propozimit për emërim, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtareve të Këshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.

13. Vendimi i Këshillit për propozimin për emërim në një pozicion të lirë, publikohet në faqen e tij zyrtare në internet dhe u njoftohet të gjithë kandidatëve të përfshirë në procedurën e përzgjedhjes për emërim, të cilët kanë të drejtën të paraqesin ankim, brenda 5 ditëve, në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.

14. Në rastin kur gjykata pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e propozimit për emërim, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.

15. Vendimi i Këshillit për propozim për emërim, që ka marrë formë të prerë sipas ligjit, i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

16. Në rastin kur Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit, kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit.

17. Në rastin kur Presidenti i Republikës dekreton mos emërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatit me renditjen më të lartë, ky dekret

shqyrtohet nga Këshilli, jo më vonë se një javë nga depozitimi i tij pranë Këshillit.

18. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij voton shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, jo më pak se gjashtë anëtarë. Në këtë rast kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit.

19. Nëse Dekreti i Presidentit të Republikës mbetet në fuqi, Këshilli, në të njëjtën mbledhje, vendos për rihapjen e procesit të kandidimit të jogjyqtarëve për atë pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ose propozon për emërim kandidatin e renditur i dyti më lart, propozim ky që i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

VII. Zbatimi me analogji i vendimit

1. Kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të parashikuara në këtë vendim zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, edhe për ato procedura të përzgjedhjes së kandidatëve që rregullohen nga ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe që referojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në nenin 49 të tij, konkretisht në procedurat që lidhen me:

a) caktimin në pozicion të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 39, pika 4, shkronja "a";

b) lëvizjen paralele të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 43, pika 8, shkronja "b" dhe pika 9;

c) zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve të komanduar, referuar nenit 53, pika 11;

ç) caktimin në pozicion të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 166, referuar pikës 5 të kësaj dispozite.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami

SHTOJCA
KRITERET E VLERËSIMIT DHE TË DHËNA PËR METODOLOGJINË E PIKËZIMIT TË KANDIDATËVE JOGJYQTARË PËR NË GJYKATËN E LARTË

MERITAT PROFESIONALE			TOTALI PIKËVE	PIKËT NGA KLGJ	
			75		
KRITERET LIGJORE TË VLERËSIMIT	**BURIMET E VLERËSIMIT (LISTË JOSHTERUESE)**	**INDIKATORË VLERESUES PËR PIKËZIMIN (LISTË JOSHTERUESE)**	**PIKËZIMI MAKSIMAL I GRUPIT TË KRITEREVE**	**PIKËT NGA KLGJ**	**TË DHËNA PËR METODOLOGJINË**
A. Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale ***Ligji nr. 96/2016 për statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve, Neni 49(6)***			**20**		
Rezultatet e studimeve*:** ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c) "rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, (…)"	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me ecurinë e kryerjes së studimeve të ndjekura, sipas rastit nga institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.	Niveli i rezultateve të arritura gjatë studimeve për drejtësi	**2**		1 pikë - për rezultatet e studimeve të larta për drejtësi për mesatare të notave 8-9 2 pikë - për rezultatet e studimeve të larta për drejtësi për mesatare të notave mbi 9 – 10
Rezultatet e programeve të formimit fillestar: ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c)*** "rezultatet (…) të programit të formimit fillestar"	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me ecurinë e kryerjes së studimeve në programet e formimit fillestar.	Niveli i rezultateve të arritura gjatë studimeve në programet e formimit fillestar	**2**		1 pikë - për rezultatet e studimeve në programin e formimit fillestar për vlerësim "Mirë/Shumë mirë" (vlerësimi një nivel më pak se niveli maksimal - sipas programit) 2 pikë - për rezultatet e studimeve në programin e formimit fillestar për vlerësim "Shumë

Rezultatet e përvojës në profesionin e juristit: ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c)*** "rezultatet (…e) përvojës në profesion"	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me rezultatet/vlerësimin/ecurinë përgjatë përvojës në profesionin e juristit	Niveli i rezultateve të arritura gjatë përvojës në profesionin e juristit	**4**		mirë/Shkëlqyeshëm" (vlerësimi për nivelin maksimal - sipas programit) 2 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë përvojës për vlerësim "Mirë"/"Shumë mirë" (vlerësimi një nivel më pak se niveli maksimal - sipas llojit të profilit) 4 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë përvojës për vlerësim "Shumë mire"/"Shkëlqyeshëm" (vlerësimi për nivelin maksimal - sipas llojit të profilit) 0,5 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve afat-shkurtra/afatmesme (deri në 2 javë) të kryera në Shqipëri, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit) 1 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve shkurtra/afatmesme (deri në 2 javë) të kryera në vendet e BE/OECD, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit) 1 pikë - për rezultatet e
Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare, dhe gradat/titujt shkencore: ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c)*** "rezultatet (…e) çdo trajnimi tjetër"	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me trajnimet e tjera, kualifikimeve pasuniversitare, si dhe gradat shkencore brenda dhe jashtë vendit.	Niveli i rezultateve të arritura gjatë trajnimeve të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit Niveli i kualifikimeve pasuniversitare Lloji i trajnimeve dhe studimeve pasuniversitare Institucioni arsimor dhe trajnues			

		Institucioni arsimor që ka dhënë titullin shkencor, në Shqipëri apo në vendet e OECD/BE. Lloji, profili dhe tematika të dhënies së titullit akademik.	**8**		arritura përgjatë trajnimeve afat-gjata (nga 15 ditë - 1 semestër akademik) të kryera në Shqipëri, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit) 2 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve afat-gjata (nga 15 ditë - 1 semestër akademik) të kryera në vendet e BE/OECD, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit) 2 pikë - për studimet (rezultatet) pasuniversitare (master në ligj) të kryera në Shqipëri 3 pikë - për studimet (rezultatet) pasuniversitare (master në ligj) të kryera në vendet e BE/OECD 2 pikë - për rezultatet e larta përgjatë studimeve të doktoraturës në ligj të kryera në Shqipëri (95-100 pikë) 3 pikë - për rezultatet e larta përgjatë studimeve të doktoraturës në ligj

					të kryera në vendet e BE/OECD (95-100 pikë) <u>Pikët për gradat shkencore:</u> 2 pikë - për titullin Profesor i Asociuar në Shqipëri 3 pikë - për titullin Profesor i Asociuar në vendet e BE/OECD 3 pikë - për titullin Profesor në Shqipëri 4 pikë - për titullin Profesor/Profesor Emeritus në vendet e BE/OECD

Aftësitë gjuhësore: ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(ç)*** ç) aftësitë gjuhësore, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit. ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(3)*** "Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ka përparësi në vlerësim."	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me certifikimin ose evidentimin e zotërimit të gjuhëve të huaja, duke përfshirë dokumentet që provojnë studimet dhe punën jashtë vendit. Intervista. Botime ose dokumente të përgatitura dhe të dorëzuara nga kandidati në gjuhën përkatëse	Lloji, shkalla e zotërimit dhe institucioni ku është vlerësuar njohja e gjuhës së huaj.	**4**		Këshilli mund të konsiderojë të vlerësojë dhe të pikëzojë me përparësi, sidomos njohuri në gjuhën angleze dhe franceze (gjuhët e GJEDNJ). 1,5 pikë - Anglisht (0,5 pikë për secilin nga tre nivelet) 1,5 pikë për Frëngjisht (0,5 pikë për secilën nga tre nivelet) 1 pikë - për të gjitha dhe çdo gjuhë tjetër të BE-së (0,5 pikë për secilin nga dy nivelet)

B. Kualifikimi i përgjithshëm profesional ***Kushtetuta, neni 136(3); ligji nr. 96/2016, neni 49(6)(b)***			**25**		
Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(b) b) vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit;	Jetëshkrimi Punime dhe dokumente profesionale të kandidatit, të përgatitura në përmbushje të funksioneve dhe veprimtarive profesionale, sipas profilit përkatës, ku përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to: - vendime gjyqësore - kontrolli incidental, - kërkesa për gjykim, - pretenca, padi, parashtresa të mbrojtjes së çështjes, mjete të kundërshtimit të vendimeve, - akte administrative dhe parashtrime në praktika administrative të përgatitura me kontribute nga kandidati, - përfaqësime të ndryshme të interesave publike ose private përpara organeve të drejtësisë ose institucioneve brenda apo jashtë vendit, - botime shkencore, prezantime, artikuj dhe publikime shkencore e profesionale. Dokumente, ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë	Vlerësimi dhe identifikimi i rezultateve profesionale më të spikatura dhe më të shkëlqyera. Rezultatet e vlerësimit profesionale të nxjerrë nga 5 dokumente të paraqitura dhe përzgjedhura nga vetë kandidatët si më të përshtatshmet për t'u shqyrtuar, të cilat vlerësohen nga Këshilli në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, për tregues të tillë si: - Origjinaliteti dhe impakti i dokumentit në veçanti në zhvillimin a krijimin e jurisprudencës gjyqësore, dhe në elaborimin e doktrinës juridike; - Aftësitë analitike dhe hulumtuese; - Saktësia, konciziteti dhe zhvillimi logjik i koncepteve juridike, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe	(5 pikë për çdo komponent / dokument)		Këshilli mund të marrë në konsideratë sasinë si edhe cilësinë e rezultateve profesionale, duke vendosur sistem pikëzimi për çdo libër shkencor ose artikull shkencor të botuar, institucionin ku është botuar, impaktin, kërkesat e pranuara të avokatëve në Gjykatën Kushtetuese, çështjet paragjykimore të paraqitura si gjyqtar e të pranuara nga Gjykata Kushtetuese, etj. Këshilli mund të akordojë pikë të veçanta nëse kjo veprimtari është kryer edhe në vendet e BE/OECD apo në gjuhë të huaja. (për më shumë shiko Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit)

	kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli. Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente zyrtare që tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare. Statistika profesionale nga institucione kompetente	gjithëpërfshirja; - Aftësia për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës, si dhe kurajë profesionale për të treguar dhe argumentuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit; - Aftësia për të referuar dhe trajtuar me efektivitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit e qëllimit të aktit, të praktikës e konsoliduar gjyqësore, praktikës së unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, asaj të GJEDNJ-së, GJDBE-së dhe jurisprudencës në tërësi.			
C. Kualifikimi shtesë profesional ***Ligji nr. 96/2016, neni 49(6)(a); ligji nr. 98/2016, neni 31(1)(2)***			**30**		
Specializim në fushën e: ***A. të drejtës civile, duke përfshirë të drejtën tregtare dhe familjare, ose*** ***B. të drejtës penale, ose*** ***C. të drejtës administrative*** ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(a)*** a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë.	Jetëshkrimi Dokumente zyrtare për angazhimin dhe rezultatet e procesit të vlerësimit profesional. Dokumente profesionale që tregojnë fushën e specializimit,	Kandidatët që kanë <u>ekspertizë në një fushë specifike</u> të ligjit vlerësohen në lidhje me: - kohëzgjatjen e angazhimit në këtë fushë; - botimet relevante - ndikimi i rezultateve profesionale			Kandidatët që kanë ekspertizë në një fushë të caktuar juridike vlerësohen në lidhje me: <u>6 pikë - kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike si më poshtë</u>: 1 pikë - për angazhimin

Ligji nr. 98/2016, Neni 31(1)(2) 1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. (...). 2. Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, (...). ***Kushtetuta Neni 136(3)*** (...) Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur (...).	krahas cilësisë dhe arritjeve gjatë përvojave të punës, ku mund të përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, edhe dokumentet e përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli. Dokumentet zyrtare për angazhimet profesionale. Dokumentet, mes atyre që u përmendën më lart, të përzgjedhura nga vetë kandidati, duke dëshmuar angazhimin, ekspertizën dhe ndikimin e angazhimit. Informata specifike zyrtare dhe dokumente mbi pjesëmarrjen në veprimtari shkencore, hartimin e legjislacionit dhe aktivitete të tjera profesionale.	në këtë fushë, në krijimin e zhvillimin e jurisprudencës dhe të doktrinës juridike; - etj. Rezultatet profesionale vlerësohen nga Këshilli në lidhje me rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, për të pasuruar kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë me profesionistë të spikatur nga fusha e së drejtës civile, penale dhe administrative. Lloji dhe kohëzgjatja e angazhimit të posaçëm apo të profilizuar, për fusha konkrete të së drejtës: - në veprimtari të caktuara profesionale; - në funksione institucionale, të lidhura me ushtrimin e profesionit. Lloji dhe rëndësia e angazhimeve të tjera profesionale në fushën përkatëse të së drejtës, në pesë vitet e fundit.			në fushën specifike për një kohëzgjatje nga 1 deri në 3 vjet 2 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 3 deri në 6 vjet 3 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 6 deri në 9 vjet 4 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 9 deri në 12 vjet 5 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 12 deri në 15 vjet 6 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 15 vjet 2 pikë - botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në këtë fushë 2 pikë shtesë - botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në këtë fushë të publikuara në vendet e BE / OECD 2 pikë shtesë - për impaktin e botimeve relevante në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore në

		Natyra dhe shkalla e kontributit konkret të dhënë në këto veprimtari, ku vlerësohen, por pa u kufizuar: - prezantimet, në fushën përkatëse të së drejtës, në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; - pjesëmarrja si përfaqësues, ekspert etj. në organizata ndërkombëtare; - pjesëmarrja në grupe pune dhe kontributet konkrete në nisma të konsultimit dhe procese legjislative për hartimin e legjislacionit në fushën përkatëse të së drejtës; - konsulenca profesionale në fushën përkatëse të së drejtës apo ligjit, të dokumentuara; Ecuria dhe ngritja në karrierë e kandidatit, në institucione shtetërore brenda a jashtë vendit, në nivelet e organeve të sistemit të drejtësisë (Gjykatë/ Prokurori e Shkallës së Parë e deri në GJL, GJK, PP, në administratën			këtë fushë 4 pikë - konsulencat në fushën përkatëse të së drejtës dhe në veçanti e shoqëruar me kontributet në hartimin e legjislacionit (bazuar në të dhëna të dokumentuara) 2 pikë shtesë - konsulenca në fushën përkatëse të ligjit në vendet e BE / OECD Këshilli mund të vlerësojë në veçanti edhe: 2 pikë - prezantime, në këtë fushë, në konferencat shkencore kombëtare (bazuar në fjalimet e dorëzuara) 2 pikë shtesë - prezantimet, në këtë fushë, në konferencat shkencore ndërkombëtare në vendet e BE / OECD (bazuar në fjalimet e dorëzuara) 2 pikë - përvojë si pedagog me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si "profesor vizitor", në këtë fushë, në vendet e BE / OECD

		publike, në institucione arsimore e shkencore etj.)			2 pikë - çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE / OECD 4 pikë - mësimdhënie, në këtë fushë, për profesionistët (p.sh. gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.) (Shënim: Juristët e spikatur mund të vërehen nga eksperienca e tyre e mëparshme e veçantë në Shqipëri apo në institucionet ndërkombëtare apo në vendet e BE / OECD)
Meritat morale dhe etike ***Kushtetuta neni 136(3), ligji nr. 96/2016, neni 49(6)(b)***			**15**		
Integriteti moral dhe etik ***Kushtetuta Neni 136(3)*** (...) Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur (...). ***Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(b)*** b) vlerësimin e punës së kandidatit (...);	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës. Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore. Informacione dhe opinione të ardhura nga	Niveli e kërkuar e i pritshëm i shkallës së lartë të zotërimit të integritetit etik dhe të cilësive morale të domosdoshme për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës se Larte. Paraqitja, sjellja, cilësia, besueshmëria, dinjiteti dhe profesionalizmi i			(për më shumë shiko Metodologjinë e Vlerësimit dhe Pikëzimit)

	institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill.	treguar gjatë intervistës. Gatishmëria, korrektesa, saktësia dhe cilësia në komunikimet me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe në përgjigjet e parashtruara gjatë zhvillimit të intervistës. Performanca profesionale dhe jetësore e kandidatit/es në shoqëri, në publik dhe ndërmjet kolegëve.			
MERITAT ORGANIZATIVE DHE MENAXHERIALE			**10**		
(Shënim: KLGJ në kërkim të "juristëve të spikatur" për në Gjykatën e Lartë, në zbatim të Kushtetutës: ***Neni 136(3)*** (...) Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur (...). Mund t'i referohet për ide edhe: Nenit 240 të ligjit për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, neni 74 (Aftësitë organizative) dhe neni 76 (Aftësitë personale dhe profesionale të tjera) të ligjit për statusin	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e meritave organizative dhe meritave personale të tjera gjatë përvojave të punës. Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga	Cilësia, thellësia dhe origjinaliteti i vlerësimeve dhe objektivave të identifikuara për çështjet e organizimit dhe funksionimit cilësor dhe efektiv të Gjykatës së Lartë në ushtrimin e			2 pikë - Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin 4 pikë - Aftësitë e provuara organizative dhe për të marrë vendime dhe përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore

	institucione të tjera shtetërore. Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë. Informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill.	funksioneve që i ngarkon Kushtetuta dhe ligji. Niveli i aftësive të fituara në përvojat, pozicionet dhe përgjegjësitë e ushtruara për aspektet e administrimit të punëve. Ecuria dhe arritjet e kandidatit/es në ushtrimin e këtyre detyrave.			2 pikë - Aftësitë e komunikimit 2 pikë - Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore.
TOTALI I PIKËVE PËR RENDITJEN E KANDIDATIT			**TOTALI I PIKËVE**	**PIKËZIMI NGA KLGJ-ja**	
			100		

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 364 lekë